



DRITA ISLAME

Botim i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë / Çmimi: 250 Lekë / www.dritaislame.al

Viti XXXV / Nr. 07 / KORRIK-GUSHT 2026

**TË MOS PËRULËSH ASKËND
TË MOS LËNDOSH...**



“DRITA ISLAME”

**Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë**

www.dritaislame.al

DREJTOR

Dorian Demetja

KRYEREDAKTOR

Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA

Erzen Carja

KONTAKT:

Tel/fax +355 68 87 71 655

E-mail: mehmet.disha@kmsb.al

Viti XXXV i botimit

Nr. 07 (517)


Korrik-Gusht, 2026


ISSN 2226-7115

*Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen, nuk
paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.*



www.dritaislame.al





editorial

04 Të mos përulësh askënd, të mos lëndosh
Redaksia

në fokus

06 Hz. Muhamedi (s.a.v.) në botën moderne
Prof. Dr. Aqhan Tekinesh

10 Pushimet e Myslimanit
Elton Karaj

lajme / aktivitete

12 01-Kryetari Spahiu viziton ambasadorin e ri të ambasadës së Arabisë Saudite në Tiranë
02-Instituti i studimeve islame "Hafiz Sabri Koçi" diplomoi 26 studentë në vitin e tij të pestë
03-Kolegji Universitar "Bedër" diplomon brezin e trembëdhjetë të studentëve
04-Kryesia e Komitetit Mysliman të Shqipërisë zhvilloi takimet vjetore me myftinitë
05-Zhvillon punimet forumi evropian "Shared Sacred Flourishing"

refleksione

18 Dy pika dhe dy gjurmë më të dashura për Allahun
Tauland Bica

20 Kur'ani si pasqyrë e vetes
Haki Sahitaj

çështje fetare

22 A lejohet të lexoj fizikisht nga Kurani, kur jam duke falur namaz? / Këshilli për Çështjet Fetare - insi.al

familja

24 Edukimi fillon në familje
Jonida Cikalleshi

horizonti i besimit

26 Dinjiteti i individit në Islam dhe bullizmi
Klodian Tafani

28 Etika e punës në Islam
Hysni Skura

30 Mbi alegorinë e njeriut dhe mbi alegorinë e njeriut dhe përgjegjësinë e tij / Raghīb al-Isfahani

32 Nderim botës me më të lavdëruarin e gjithësisë (Lindja e Muhamed Mustafasë) / Resul ef. Rexhepi

hapësirë femënore

36 Me shokët e Profetit ﷺ
Hapësirë femënore

këndi i poezisë

38 Poezi kushtuar profetit Muhamed a.s.
Vexhi Buharaja



TË MOS PËRULËSH ASKËND TË MOS LËNDOSH...

Të mos përulësh askënd, të mos lëndosh

Në një hadith që kalon te Tirmidhiu, Profeti Muhamed (a.s.) thotë kështu: *"Kush e turpëron (gjykon) vëllain e tij për shkak të një gabimi apo gjynahu që ka bërë, Allahu nuk ia merr shpirtin pa e kryer edhe vetë të njëjtin gjynah."*

Në hadithin e mësipërm, tregohet se kush e turpëron vëllain e tij për një gjynah që e ka kryer ose nuk e ka kryer, nuk do të vdesë pa e kryer vetë të njëjtin gjynah. Si rezultat i gjykimit, apo fajësimit të një gjynahu, mund të ndodhë që të përjetojë një problem një person i afërm i familjes, qoftë ky, djali, vajza, bashkëshortja etj. Domethënë, Allahu ndonjëherë bën që ta vuajë vetë personi dënimin, ndonjëherë lëshon vuajtje për pjesëtarët e tjerë të familjes. Në shumicën e rasteve personi mund të dalë prej situatës së krijuar nga problemet e ndryshme, por kur bëhet fjalë për njerëzit e afërm, kjo gjë bëhet më e vështirë për të.

Vuajtja në këtë botë mund të jetë edhe si dëmshtëpërlim për gjynahet e atij personi duke e shpëtuar nga dënimi në Ahiret. Por ndonjëherë ndodh që gjynahu mund të jetë aq i madh sa që nuk mjaftojnë vuajtjet e kësaj bote për ta pastruar. Për shembull, përdhosja e të drejtave, shkelja e të drejtave të njeriut, kërcënim i sigurisë së jetës dhe pasurisë, tallja me nderin, shirku, kufri, hipokrizia etj., padyshim që një person që ka kryer këto krime, do të përballë me dënimin e rëndë të Ahiretit.

Asnjëherë nuk mund ta dimë urtësinë e këtyre ndodhjeve. Allahu ndonjëherë na e jep dënimin në këtë botë, ndonjëherë

e lë për në botën tjetër. Nëse nuk duam të përjetojmë një turpërim të tillë as në këtë botë, as në Ahiret, duhet t'i dalim për zot gjuhës fillimisht ndaj besimtarëve dhe pastaj ndaj të gjithë njerëzve, sa që duhet t'i rishikojmë mendimet tona ndaj tyre.

Në një hadith tjetër profeti Muhammed (a.s.) thotë: *"Kush më garanton mua atë që ka mes dhëmbëve dhe mes këmbëve unë i siguroj atij xhenetin."*

Nga ky aspekt gjuha është shumë e rëndësishme, në fillim ta mbash mbyllur gojën është shumë e lehtë. Por pasi fillon të flasësh, është shumë e vështirë t'i mbledhësh e t'i riparosh gjërat të cilat i ke thyer. Më e thjeshta e cila është përtej gabimit ose gjynahut të bërë, kur i hyjmë në hak një personi, ajo që duhet të bëjmë është t'i kërkojmë atij hallallin. Në të kundërt do të shkojmë në Ahiret me barrën e këtij gjynahu.

Edhe kur gjendemi në rrethana për të treguar një ngjarje, duhet të jemi shumë të kujdesshëm, pa i shkelur kufijtë. Duhet t'i përzgjedhim aq shumë fjalët në mënyrë që askush të mos pësojë dëme apo të preket nga fjalët tona. Por, nëse gjatë shpjegimeve tona themi filani e bëri kështu e bëri ashtu, për faj të tij na ndodhën gjithë këto gjëra, atëherë të jemi të sigurtë që kemi marrë në qafë shumë shpirtra, kemi bërë një bisedë të ngritur mbi themelet e keqpandehmës dhe si rrjedhojë, jemi bërë pjesë e ngarkesave shumë të mëdha gjynahesh.

Profeti (a.s.) nëpërmjet hadithit të mësipërm na tregon se Allahu do të na dënojë edhe neve duke kryer të njëjtin gjynah që kemi gjykuar, apo përgojuar. Po nëse personat janë të pafajshëm për ato gjëra që akuzohen? Dëmi është akoma edhe



më i madh në rastin ku akuzohen njerëz pa të drejtë, tërësisht të pafajshëm. Në rast se akuzohen grupe njerëzish, atëherë duhet t'u merret hallalli secilit prej individëve që janë pjesë e atij grupi. Nuk bëhet fjalë që lojëra të tilla kaq të ulëta, që janë të barazvlefshme me mohimin, të mund t'i bëjnë besimtarët.

Besimtari, ashtu siç tregohet i kujdesshëm në ruajtjen e nderit të vet, po aq i kujdesshëm dhe i ndjeshëm duhet të tregohet edhe ndaj nderit të të tjerëve. Ai nuk duhet të cenojë as me dorë e as me fjalë askënd, madje jo vetëm kjo, por edhe mendimet e ndotura duhet t'i mvëshë me mendime të bukura dhe këtë gjë duhet ta bëjë pjesë të natyrës së tij. Nga vetë fjala mu'min- besimtar, të gjithë njerëzit përreth duhet të ndihen të sigurtë. Një besimtar i vërtetë duhet të pretojë aq shumë siguri, saqë askush të mos ndihet i cenuar se mund t'i ndodhë diçka prej tij, madje, edhe nëse i bën vetë atij një të keqe, e di shumë mirë që ai nuk do t'i kthehet me të njëjtën mënyrë.

Është shumë e rëndësishme që disa sjellje të bëhen pjesë e karakterit të njeriut. Gjithsecili ka një karakter të vetin që nga lindja. Por, të bashkëngjitur me të, ka edhe karakterin e fituar me njohjen e Islamit. E pra, një mysliman që përfaqëson karakterin e Islamit, sjelljet që ia kërkon morali i bukur i kësaj feje, duhet t'i veprojë shumë natyrshëm, pa u vështirësuar fare. Nëse një njeri është ngjyrosur me moralin e Islamit, atëherë kundrejt çdo të keqeje ai nuk lëshon pe nga karakteri i tij dhe asnjëherë nuk reagon në të njëjtën formë, përkundrazi.

Por nëse nuk e kemi bërë pjesë tonën një moral të tillë, do të vështirësohemi në shumë aspekte dhe nuk do të arrijmë gjithmonë të tregojmë një vendosmëri të tillë. Në momentin e parë kur do të na preket damari, atëherë do t'i nxjerrim kthetrat menjëherë duke i lënë me gojë hapur njerëzit nga sjelljet tona. Prandaj është shumë e rëndësishme që vazhdimisht duke bërë praktikë, ta bëjmë pjesë të karakterit tonë një sjellje të tillë.

Të mos përzihesh në punët e të tjerëve.

"Mos e përgojoni njëri tjetrin, mos rrëmoni në gjendjet e fshehta të njëri tjetrit" (Huxhurat 49/12)

Njerëz që vazhdimisht bëhen gjahtarë të gabimeve të të tjerëve, vjen një pikë që pësojnë deformime serioze në karakterin e tyre. Këta njerëz jo vetëm që bëhen gjynahqarë shumë të mëdhenj ndaj vetes së tyre, por fillojnë dhe nxinë edhe njerëz shumë të pastër dhe do të përhapin vrer ngado që shkojnë, ndërkohë që mund të zgjedhin të bëjnë të kundërtën e kësaj, ku ngado që të shkojnë të përhapin dritë.

Imam Hadimi në veprën e tij 'Berika' thotë kështu: "edhe nëse e shikon një besimtar në një gjendje shumë të keqe, mos jep menjëherë gjykim për të. Fshiji sytë, mos ndoshta nuk e pashë mirë? Ky njeri nuk mund ta bëjë një gjynah të tillë dhe kthehu edhe një herë të shikosh nëse është e vërtetë apo jo, në mënyrë që të mos arrish të japësh një gjykim të gabuar.

Shikoje edhe njëherë duke pandehur se je ti gabim në atë çka ke parë, dhe pasi ta kesh kontrolluar dhjetë herë këtë, dhe të kesh vërtetuar që është e vërtetë ajo çka ke parë, atëherë thuaj kështu: "O Zot! Shpëtoje nga kjo gjendje e shëmtuar këtë njëri dhe më ruaj edhe mua nga rënia në këtë gjynah!" dhe lagohu nga aty, thotë imami.

Nëse dikush gjendet përballë një situatë të tillë, ajo çka është më e duhura të bëjë, është të kthejë shpinën menjëherë dhe të thotë: "ndoshta e kam parë gabim dhe të mos e përmendë asnjëherë më atë gjë. Sepse detyra që na ka dhënë Zoti ne, nuk është të rrëmojmë gjynahet e të tjerëve."

Nuk duhet harruar që një ndër emrat e Allahut është "Settar"- Mbulues i të metave. Ajo që i takon myslimanit është të bëhet njësh me moralin e Allahut. Në një hadith të Profetit a.s thuhet kështu: "Kush mbulon të metat e tjetrit në këtë botë, Allahu do t'ia mbulojë atij në botën tjetër"

Të mos përulësh askënd, të mos lëndosh

Në një hadith thuhet kështu: "I mjafton si e keqe dikujt që përul vëllain e tij besimtar (pra, të luash me nderin e tij, e shkatërron atë njeri në botën tjetër)". Çdokush që i beson Allahut nuk mund të merret lehtë me diçka të tillë. Edhe nëse nuk është mysliman sipas hz. Aliut, nga vetë pikëpamja njerëzore, ne jemi të gjithë të barabartë dhe vetëm duke u nisur nga kjo, ne nuk mund të përulim askënd. Te çdo njeri mund të gjenden cilësi negative. Ajo çka na takon neve përballë këtyre gjërave është të lutemi për udhëzimin e këtyre njerëzve. Profeti (a.s) asnjëherë në gjithë jetën e Tij nuk ka përçmuar askënd. Nuk është një sjellje prej besimtari të përçmuarit e dikujt, as t'i gjykojë, as t'i rrisë sjelljet e tij lart e poshtë. Si myslimanë ajo çka na takon të bëjmë, është të marrim shembull nga gabimet e të tjerëve dhe me sa të kemi mundësi t'i ndihmojmë ata njerëz në përmirësimin e gjendjes së tyre, dhe të bëjmë dua duke u përgjyruar, që Allahu të mos na bëjë edhe neve të jetojmë të njëjtën gjë.

Akoma më tepër kujdes duhet treguar ndaj njerëzve që kanë qenë gjithmonë në atmosferën e posteve dhe pozitive, pasi vetë ambienti ua bën shumë herë më të vështirë që ta kapërdijnë gabimin e tyre nëse ua përplas atë në fytyrë.

Sa shumë herë janë përpjekur që të na bëhen pengesë apo të na sulmojnë armiqtë. Disa herë madje i kanë shkatërruar rrugët tona duke i sjellë në një gjendje të pakalueshme. Na i këputën të gjitha lidhjet tona. Jemi akuzuar me pa të drejtë duke hedhur mbi ne një sërë gënjeshtërash dhe shpifjesh. Në rastin e parë që gjejmë, menjëherë na sulmojnë shumë padrejtësisht. Sidomos kohët e fundit jemi gjendur përballë dëmsh shumë të rënda. Pavarësisht të gjitha këtyre, ne asnjëherë nuk kemi bërë të njëjtën gjë, madje as neper mënd nuk e kemi çuar që të merremi dhe t'i turpërojmë këta njerëz.

Hz. Muhamedi (s.a.v.) në botën moderne

Krahas orientalizmit modern të prodhuar nga elementët materializues të kulturës evropiane në shek. XVIII¹, në Perëndim nisi të ndryshonte vështrimi ndaj Islamit dhe Hz. Muhamedit (Falja dhe Paqja e Allahut qofshin mbi të). Në Mesjetë, njohuritë mbi Profetin mbështeteshin mbi një sërë besëtytnish dhe supersticiozitetesh. Kurse që nga shek. XVIII nisën të dalin në shesh studime mbështetur mbi parime shkencore me pretendimin për të qenë të paanshme. Në shek. XIX, punimet lidhur me historinë e Islamit të marra në dorë nga autorë, si Reinhart Dozy (1820-1883) dhe William Muir (1819-1905), duhen pranuar sepse janë produkte të një përpjekjeje serioze. Ndërkaq, tek këta autorë vëzhgohet një neveri interesante ndaj Lindjes dhe Islamit. Ajo çka kërkonin të bënin orientalistët me studime të tilla, ishte që, duke mos lënë asgjë pa thënë mbi Hz. Muhamedin, ta tregonin atë, nën një dritë të ftohtë, të zhveshur edhe nga fuqia fetare e gjerë, edhe nga forcat e pashpjegueshme që e rrëqethin europianin.² Orientalistët e asaj periudhe patën shpenzuar përpjekje të mëdha që, duke e temporalizuar Hz. Muhamedin, të mund ta paraqisnin atë jo si një profet të vërtetë, por një lider materialist. Kështu, orientalisti i famshëm Caussin pretendon se Islami është, në themel, një kontratë politike, s'është kurrësi një kontratë spirituale.³ Gjithashtu, në të njëjtën periudhë, disa orientalistë që përpiqeshin të ishin objektivë në çështjen e Islamit, e patën përshkruar Hz. Muhamedin duke i nxjerrë në plan të parë cilësitë sekulare, si "një hero që e kishte ndikuar Europën, me pikëpamje të kthjellëta, i sigurtë në vetvete."⁴

Biografite në fjalë, të shkruara mbi Profetin në Perëndim, të dukura si relativisht të paanshme në krahasim me biografite e ngjashme të periudhave të kaluara, kanë ndikuar edhe mbi intelektualët myslimanë. Gjithashtu, rrymat ideore nga të cilat u ndikuan orientalistët në të njëjtën periudhë, edhe disiplinat e reja shkencore që sapo filluan të dalin në shesh, i vunë nën ndikim mendimtarët myslimanë. Në përfundim të kësaj, studimet e bëra në Perëndim lidhur me historinë e Islamit, u pritën me pëlqim nga disa intelektualë të vendeve islame; ndërsa një pjesë u përktuhyen menjëherë⁵, një pjesë intelektualësh myslimanë

shkruan me metoda të ngjashme vepra mbi jetën e Profetit. Për më tepër, disa nga autorët arabë, duke u ndikuar nga autorët perëndimorë, ndërsa e mohuan hapur profetësinë e tij, thanë se, me gjenialitetin dhe me sukseset politike dhe ushtarake, ai kishti qenë njeri i madh. Mjeku arab i famshëm i quajtur Shibli Shumejjil (vd. 1917), në letërën që i pati shkruar Reshid Rizait, pati thënë: "Sipas meje që nuk i besoj Allahut dhe revelacionit hyjnor dhe që nuk e njoh atë si profet, ai është më i madh se ç'e shih ti të Dërguar të Allahut."⁶ Në Egjipt, intelektualë si Ferid Vexhdi, Doktor Zeki Mubarek, Abbas Mahmud el-Akkad⁷ dhe Hejkel Pasha, në shkrimet e tyre mbi Profetin, nuk u patën dhënë vend mrekullive kozmike, nuk patën qëndruar mbi dimensionin e profetësisë po në atë masë sa ç'e patën përshkruar heroizmin dhe gjenialitetin e tij (Abkarije). Prandaj e patën fajësuar personin e përmendur si Mustafa Sabri Efendi (vd. 1954) "për përpjekje për ta zëvendësuar profetësinë me gjenialitetin."⁸ Madje, ai pati thënë se mohimi i mrekullive kozmike dhe nënvleftësimi i dimensionit okultist të profetësisë dhe pranimit i pretendimit të disa orientalistëve, sipas të cilëve "Muhamedi ka qenë një hero i dalë në shesh si profet", do të jepte rezultate.⁹ Mustafa Sabri Efendi nuk është kundër që të flitet për gjenialitetin e profetit Muhamed. Sipas tij, mrekullia është veçoria e pashmangshme e pozitës profetike. Kurse autorët e sipërpërmendur, duke e zëvendësuar gjenialitetin me mrekullitë kozmike, duan ta tregojnë gjenialitetin si mrekulli të pashmangshme të profetësisë. Kurse nuk ka ndonjë të keqe që, në vartësi të pozitës profetike, të flitet për gjenialitetin e tij.¹⁰

Krahas faktit që pikëpamja materialiste mbi botën që bërë sunduese mbi mendimin perëndimor dhe katedrat shkencore, edhe karakteri mistik i krishterizmit u bënë ndikues në formimin e pikëpamjeve të autorëve krishterë në çështjen e profetit Muhamed. Ndërsa disa autorë myslimanë që shkruanin biografinë e Profetit, trajtonin atë me një këndvështrim temporal dhe antikrishter, krishterët, edhe në rastin më të mirë, patën dashur ta shohin atë të "justifikuar" me një lloj vështrimi psikologjik nga lart.¹¹

cüme edilerek 1907 yılında Tarih-i İslamiyet adıyla neşredilmiştir.

1. Edward W. Said, Şarkiyatçılık, Batı'nın Şark Anlayışları, çev. Berna Ülner, İstanbul 1999, s. 130.

2. Edward W. Said, a.g.e., s. 162, 163.

3. Caussin de Perceval, Essai sur l'histoire des Arabes avant l'Islamisme, 1847-48 (yeni basım Graz 1967), III, 332-9'den nakleden Edward W. Said, a.g.e., s. 162.

4. Edward W. Said, a.g.e., s. 163, 130.

5. Mesela Dozy'nin İslam tarihiyle ilgili Essai sur l'histoire de l'Islamisme adlı eseri doktor Abdullah Cevdet tarafından ter-

6. Bk. Ali Şeriatî, Muhammed'i Tanıyalım, çev. Ali Seyyidoğlu, Ankara 1996, s. 10.

7. Mustafa Sabri, Mevkıfı'l-akl ve'l-ilm ve'l-alem min Rabbi'l-alemin, Kahire 1950'den ofset, IV, 11 vd.

8. Mustafa Sabri, a.g.e., IV, 4 vd.

9. Mustafa Sabri, a.g.e., IV, 6.

10. Mustafa Sabri, a.g.e., IV, 9.

11. Schuon, Frithjof, İslam'ı Anlamak, çev. Mahmut Kanık, İstanbul 1988, s. 140.

Sepse për ta, prototipi i profetit mistik të kulluar të papërzier në punët e kësaj bote ishte Jezusi. Autorët krishterë, duke shënuar vazhdimisht drejtimin temporal të profetit Muhamed në dallim nga profeti Jezus (Isa), kanë zhvilluar tezën, sipas së cilës, “nga Isai dhe të tjerë themelues fesh, profeti Muhamed tregon dallueshmëri në të njëjtën kohë edhe si krijues i një bindjeje, edhe si person që ka hedhur themelet e një shteti”.¹² Sepse, sipas tyre, Muhamedi është, para së gjithash, themelues edhe një ideologjie, edhe i një shteti.¹³ Për këtë shkak, pretendojnë se Muhamedi nuk ka dimension moralo-shpirtëror, se nuk mundet të krahasohet me Jezusin, mbase mund të ballafaqohet me profetët e bijve të Izraelit. Kështu, Hitti thotë se “Islami, më tepër se me krishterizmin që parashtroi Ungjilli, është afër me hebraizmin që predikoi Tora”.¹⁴ Si pasojë e bindjes së tyre në çështjen e Jezusit, është mjaft e vështirë që autorët krishterë të konceptojnë rëndësinë moralo-shpirtërore dhe rolin e tij si prototipi i jetës shpirtërore dhe fetare.¹⁵ Sipas Louis Massignon-it si orientalisti ndoshta më i famshëm dhe më me ndikim ndër orientalistët modernë francezë, “Islami është një kundërshtim sistematik ndaj idesë së gjetjes nga Zoti trup tek Jezusi.” Për këtë shkak, sipas tij, heroi më i madh i Islamit nuk është Muhammedi, por mistiku musliman Hallaxhi Mansur (Mansur Pehlevi – M.H.) i cili pati treguar guximin për ta personifikuar Zotin. Kështu, Massignon-i e ka nxjerrë Hallaxhi Mansurin në plan të parë me mendimin se është figurë e Jezusit. Këtu, është e mundur të tregohet një model i dëshirës së orientalistëve për ta modifikuar Orientin qoftë edhe me shtrëngesë me terminologjinë e Oksidentit.¹⁶

Një tjetër shkak që, duke u përqendruar me këmbëngulje mbi cilësitë temporale të Hz. Muhammedit, është nënvleftësuar aspekti i tij moralo-shpirtëror, është mjedisi social dhe kulturor ku jetohet. Ngaqë në botën moderne jeta fetare është ndarë nga fushat e tjera, fakti që profeti Muhamed, krahas gjenialitetit politik, forcës oratorike të komunikimit dhe cilësive si burrë shteti, ka qenë edhe udhërrëfyes në fushat fetare dhe moralo-shpirtërore për njerëzit, nuk është kuptuar dot që jeta e tij ka përbërë model për ata që kanë dëshiruar asketizmin dhe devocionin. Shumë njerëz të ditëve të sotme e kanë të vështirë të kuptojnë sukseset e një personaliteti shpirtëror në fushën sociale dhe politike.¹⁷ Sepse në Perëndimin krishter, veçanërisht kohët moderne, ndodh mjaft rrallë që të haset një lider i suksesshëm në fushat politike dhe shoqërore, i cili, në të njëjtën kohë, të ketë edhe një personalitet moralo-shpirtëror. Prandaj heqin keq autorët perëndimorë për të

rrokur personalitetin e profetit Muhammed. Kjo specifikë është edhe njëri nga shkaqet që, në veprat e shkruara në Perëndim lidhur me profetin Muhammed, aspekti moralo-shpirtëror i tij nënvleftësohet vazhdimisht. Për më tepër, sipas oksidentalistëve, ajo çka njihet më pak mbi parimet themelore të Islamit, është entiteti i vërtetë i Muhammedit.¹⁸

Anashkalimi i aspektit moralo-shpirtëror të profetit Muhamed ka edhe shkaqe psikologjike. Njëra prej më të rëndësishmeve të tyre është mungesa e empatisë. Për ta kuptuar rëndësinë e vërtetë të Profetit, është e pamjaftueshme që tekstet lidhur me jetën e tij të shqyrtohen nga jashtë. Duhet edhe që ai të vlerësohet nga këndvështrimi islam dhe të bëhen përpjekje për t’u konceptuar pozita që ka zënë ai në vetëdijen fetare të myslimanëve.¹⁹ Si rrjedhojë e kësaj mangësie, shumë vepra perëndimore lidhur me profetin Muhamed, krahas pasurisë së hollësive historike që sigurojnë për lexuesin, janë të padobishme për kuptimin e personalitetin e tij të vërtetë.²⁰

Krahas sukseseve shoqërore dhe politike të profetit Muhamed, edhe martesat dhe luftërat e tij janë specifika që bëhen shkak për komentimin e jetës së tij vetëm nga këndvështrimi material dhe temporal. Me martesat e veta, Muhamedi ka hyrë brenda sferës temporale-shoqërore. Martesat e tij nuk tregojnë dobësi “sensuale”. Përkundrazi, janë simbole të unifikimit praktik të sferës njerëzore kolektive me sferën moralo-shpirtërore.²¹ Mbi heroizmin e Profetit në luftëra nuk kanë qëndruar vetëm orientalistët; kjo temë ka tërhequr vëmendjen edhe të autorëve muslimanë. Ata, për të mundur më lehtë t’ia tregojnë Profetin njeriut modern, kanë ndërjerë domosdoshmërinë e diskutimit mbi heroizmin e tij. Kështu, Abdurrahman Azzam i cili fillon duke treguar për heroizmin e Profetit, thotë: “Mua më erdhi rëndë që t’i them hero atij profeti të madh dhe për ta treguar atë mes heronjve!”²² Sipas Ali Sheriatit, edhe sikur Hz. Muhamedi të vlerësohej duke marrë nën vëmendje vetëm sukseset ushtarake, do të numërohej ndër heronjtë e mëdhenj që ka parë historia. Vetëm se triumfet e tij ushtarake pranë cilësive të tjera janë një nga specifikat që Islami i quan si më të parëndësishmet.²³ Në këtë çështje, ai thotë: “Hz. Muhamedi nuk ishte dikushi që interesohej dhe merrej vetëm me mendimet e popullit. Megjithëse ai ishte burrë i politikës, luftës, pushtetit, bota shpirtërore, devocioni dhe dashuria binin në sy më shumë tek ai.”²⁴ Edhe Seyjid Hysejin Nasr, duke tërhequr vëmendjen për faktin se analizat moderne që e përshkruajnë Hz. Muhamedin si njeri i dhënë pas vetmisë dhe meditimit nga krijimi, e kanë

12. Cahen, Claude, Islamiyet, çev. Esat Nermi Erendor, Ankara 1990, I, 21.

13. Rodinson, Maxime, Hz. Muhammed, çev. Atila Tokatlı, İstanbul 1994, s. 213.

14. Hitti, Philip, İslam Tarihi, çev. Salih Tuğ, İstanbul 1980, I, 193.

15. Seyyid Hüseyin Nasr, İslam İdealler ve Gerçekler, çev. Ahmed Özel, İstanbul 1985, s. 77.

16. Edward W. Said, a.g.e., s. 114.

17. Seyyid Hüseyin Nasr, a.g.e., s. 77, 78.

18. Seyyid Hüseyin Nasr, a.g.e., s. 78, 79.

19. Schuon, Frithjof, a.g.e., s. 140.

20. Seyyid Hüseyin Nasr, a.g.e., s. 82, 83.

21. Schuon, Frithjof, a.g.e., s. 141; Seyyid Hüseyin Nasr, a.g.e., s. 80.

22. Abdurrahman Azzam, Rasul-i Ekrem’in Örnek Ahlâkı, çev. Hayreddin Karaman, İstanbul 1971, s. 5, 6.

23. Ali Şeriatî, Muhammed Kimdir, çev. Ali Seyyidoğlu, Ankara 1996, s. 17.

24. Ali Şeriatî, Muhammed’i Tanıyalım, s. 110.

kthyer së prapthi personalitetin e tij të vërtetë.²⁵

Vështirësia për ta përkufizuar aspektin moralo-shpirtëror të Profetit nuk është një situatë që vlen të theksohet vetëm për autorët perëndimorë. E njëjta vështirësi vlen të diskutohet edhe për autorët myslimanë. Kështë, sociologu dhe sociologu i njohur Ali Sheriati e shpreh këtë vështirësi me fjalët "Është e pamundur që njeriun ta përkufizosh vetëm duke ditur ngjarjet në jetën e tij." Sheriati i cili e përcakton me kritere të radhës se kuptimi i Hz. Muhamedit është shumë i vështirë, qëllimin e tij në veprën me titull "Ta njohim Muhamedin", e shpreh në formën "përpjekje për të mund t'iu afruar këtij Shpirti të Lartë".²⁶ Kohë më kohë, krahas faktit që u jep vend zbërthimeve psikologjike, Sheriati i cili e analizon jetën e Profetit përgjithësisht nga këndvështrimi sociologjik, e tregon të Dërguarin e Madh me fjalët: "Përballë njerëzimit, ai hapi një brazdë të re dhe një rrugë të re, i mbylli shkollat dhe hapi një shkollë të re, të gjitha kallëpet i theu dhe formoi një kallëp të ri, i fshiu mendimet e vjetra nga trutë dhe hodhi themelin e mendimeve të reja."²⁷ Nga ana tjetër, thekson se cilësia më e shquar e tij ishte një ndërgjegje e thellë dhe vazhdon kështu: "Në thellësitë e shpirtit të tij ka një burim me mistere që "ndershmëria dhe drejtësia" janë nga shfaqjet e tyre."²⁸ Sipas Sheriatit, arabët e Periudhës Paraislamike Pagane dhe Politeiste e njihnin Muhamedin më tepër se në aspektin e mendimit, në aspektin e ndërgjegjes. Për këtë arsye ia patën dhënë llagapin "el-Emin", "i Besueshmi".²⁹

Krahas faktit që mes sociologëve, ndjekësit më besnikë të botëkuptimit materialist të shek. XIX ishin orientalistët, si përfundim i pakësimit të ndikimit të filozofisë materialiste në Perëndim, në gjysmën e shekullit nisën të bëhen komente më të ekuilibruara mbi profetin Muhamed. Orientalisti marksist Maxime Rodinson, duke thënë se "ka orientalistë të cilët parapëlqejnë të nxjerrin në plan të parë dëshirën dhe kënaqësinë fetare të profetit Muhammed, vë në diskutim shqetësimin e vet nga kjo gjendje."³⁰ Orientalisti modern Montgomery Watt, duke pretenduar se profeti Muhamed ka bërë gjatë gjithë historisë islame shembull dhe prijësi për shumë personalitete mistike, thotë se duhet menduar pozitivisht mbi personalitetin e tij moralo-shpirtëror. Watt-i thotë se "besoj që Muhamedi është me të vërtetë profet dhe mendoj se ne, krishterët, duhet ta pranojmë këtë sipas parimit krishter me kuptimin "i njeht ti ata sipas fryteve të tyre" (Mateu, 7:20). Sepse për shekuj me radhë Islami ka përgatitur shumë njerëz të lartë e të devotshëm."³¹

Për më tepër, duke e përkthyer termin "Resulullah", thotë se fjala anglishte "messenger" si barazvlerëse e termit

"resul" bart kuptim sekular, prandaj, në vend të saj, duhet përdorur termi "profet".³²

Zbulimi nga orientalistët kohët e fundit i aspekteve moralo-etike dhe moralo-shpirtërore të Profetit mund të ketë edhe shkaqe politike. Theksimi i faktit se thirrja e Muhamedit mund të jetë me përmbajtje vetëm fetare dhe morale, mund të jetë edhe një pretendim i hedhur në shesh me mendimin për t'i lënë pa mbështetje në aspektin ideor luftërat çlirimtare dhe lëvizjet e xhihadit në vendet islame të intensifikuara pas Luftës II Botërore.³³ Disa nga orientalistët kanë thënë se synimi i tij i vërtetë ka qenë të ngrejë një sistem moralo-etik, se ai pati bërë përpjekje sinqerisht për të lartësuar nivelin shpirtëror dhe moralo-etik të njerëzve të mjedisit të tij. Kështu, orientalisti bashkëkohës Claude Cahen, duke treguar qëllimin e profetit Muhamed, thotë: "Si të gjithë themeluesit e feve, edhe Muhamedi nuk ka një doktrinë sociale; ajo çka bëri ai, ishte vetëm të shpallte një sistem moralo-etik... Ajo çka deshi Muhamedi në fakt ishte të krijonte një shoqëri prej njerëzish të bashkuar mes tyre me përgjegjësi reciproke dhe me një ndjenjë solidariteti të fuqishme."³⁴ Kurse në çështjen e drejtësisë, ndershmërisë dhe sinqeritetit të Muhammedit, Cahen thotë kështu: "Në kërkimin e rrugëve për ta lartësuar nivelin shpirtëror dhe moralo-etik të njerëzimit të mjedisit të tij, Muhammedi pati treguar një ndershmëri të padiskutueshme dhe një talent plot entuziazëm. Ai ka qenë një personalitet i cili, në sigurimin e përshtatjes së thirrjes së bërë prej tij ndaj traditës dhe karakterit të njerëzve ka ditur të tregojë një sukses të madh dhe një gjenialitet politik dhe, kështu, t'u përftojë atyre vitalitet. Në atë çast kur të ndjejmë në shpirt sa lartësinë sublime të këtij frymëzimi fetar, aq edhe sublimen e luftës së tij përballë vështirësive të ardhura nga njerëzit dhe përballë shqetësimeve të veta si dhe, së bashku me frymëzimin, të ndjejmë në shpirt lartësinë sublime të ecurisë, është e pamundur të mos emocionohemi thellësisht dhe të mos ndjejmë respekt për të!"³⁵

Fakti që të dhënat mbi jetën e Profetit (s.a.s.) janë me shumicë, ka dhënë mundësi që ai të mund të komentohej nga këndvështrime të ndryshme. Meqë janë gjendur shumë të dhëna dhe rrëfime historike mbi personalitetin e tij, çdo autor e ka përshkruar profetin Muhammed me veçori të ndryshme. Siç dihet, ekzistojnë njohuri mjaft të detajuara mbi jetën dhe personalitetin e Profetit. Madje, disa autorë perëndimorë kanë thënë: "Mes gjithë themeluesve të feve, nga këndvështrimi i personalitetit, Muhammedi ka karakterin historik më të qartë."³⁶ Sipas dikujt, ai ka qenë një hero, sipas dikujt tjetër, i pari socialist në historinë botërore dhe sipas dikujt tjetër, një gjeni. Nga shumë orientalistë është pranuar se nga bashkësia fetare e themeluar prej tij, duke fituar brenda një kohe të shkurtër autonominë

32. Watt, a.g.e., 99.

33. Muhammed el-Behiy, Islami Düşüncede Oryantalist Etki, çev. İbrahim Sarıış, İstanbul 1996, s. 55-88.

34. Cahen, a.g.e., I, 21.

35. Cahen, a.g.e., I, 20.

36. Cahen, Claude, a.g.e., I, 17.

25. Seyyid Hüseyin Nasr, a.g.e., s. 79, 80.

26. Bk. Ali Şeriati, a.g.e., s. 9-11.

27. Bk. Ali Şeriati, a.g.e., s. 17.

28. Ali Şeriati, a.g.e., s. 35.

29. Ali Şeriati, a.g.e., s. 29.

30. Rodinson, Maxime, a.g.e., s. 221.

31. Watt, Montgomery W., Hz. Muhammed'in Mekke'si, çev. Mehmet Akif Ersin, Ankara 1995, s. 12.

politike, doli në shesh një shoqëri dhe kulturë krejt e re.³⁷ Për më tepër, "parimet lidhur me ligjet e bashkëjetesës shoqërore i kanë hapur udhë pandehjes nga ana e historianëve bashkëkohorë se Hz. Muhamedi ka qenë një socialist i hershëm."³⁸ Dhe me të vërtetë, Muhamedi është udhëheqës, ligjvënës dhe, në jetën shoqërore, paraprijësi i njerëzve. Vetëm se nuk duhet harruar që rruga e tij e ka rrethuar jetën si një e tërë me aspektet e saj materiale dhe shpirtërore.³⁹ Si rrjedhojë e cilësive si kjo, natyra njerëzore e ka mbuluar natyrën moralo-shpirtërore, i ka fshehur nga sytë funksionet moralo-shpirtërore. Mirëpo Profeti (a.v.s.) ka marrë pjesë në jetën shoqërore dhe politike për t'i unifikuar në një qendër këto dy sfera njerëzore. Ai nuk ka qenë as një profet që ka përfaqësuar vetëm sferën metafizike. Krahës përpjekjes njerëzore që formëson dhe përcakton sjelljet e tij, është llogaria hyjnore. Çdo profet ka theksuar vetëm një aspekt të të vërtetës. Kurse Muhamedi e ka përfaqësuar të tërën e të vërtetës me një harmoni dhe ekuilibër të plotë pikërisht pse ka qenë shembulli dhe modeli i profetësisë.⁴⁰ Duke mbajtur parasysh se "e tërë e vërteta është e fshehur gjithmonë në një ekuilibër"⁴¹, kur flitet për Profetin Muhamed nuk duhen harruar, krahës, cilësive njerëzore, besnikëria, garancia, adhurimi i përkushtuar, devocioni, nënshtrimi ndaj Allahut, shkurt, perëndishmëria e tij.

Si pasojë e shkaqeve që i prekëm më lart, krahës pasurisë së hollësive historike të siguruara për lexuesit nga shumë kërkime moderne lidhur me Profetin Muhamed, janë të padobishme dhe jashtëzakonisht pa rezultat për sa i përket kuptimit të personalitetit të vërtetë të tij. Sepse këto vepra ose janë shkruar nën ndikimin e mendimit perëndimor, ose janë marrë të shkruhen si reaksion ndaj tij. Autorët modernistë myslimanë i kanë nënvleftësuar të gjitha aspektet që spërshtaten me këndvështrimin humanist dhe racionalist të përfutur a priori disa herë as pa e kuptuar Profetin. Ata janë përpjekur ta tregojnë atë si një njeri mediokër.⁴² Sezai Karakoç e shpreh kështu këtë gjendje: "Dijetarët perëndimorë i shohin profetët si udhëheqës të popujve të tyre që marrin përsipër rolin e mobilizuesit dhe shpëtimtarit në kohët kritike. Pa dyshim, profetët janë prijësa që i shpëtojnë popujt e tyre. Porse t'i shohësh ata vetëm me këto anë, do të thotë ta interpretosh tërë historinë njerëzore gabim, mangësisht dhe të mangët nga thellësia e vërtetë...Edhe sot, pak a shumë në çdo anë të botës, "intelektuali mesatar", në interpretimin e tij të kaluar e sheh Profetin nga perspektiva e pikëpamjes së mbetur nga torat. Mendësia sipas së cilës ata janë prijësa që i shpëtojnë popujt e tyre në kohë të vështira, me kalimin e kohës po fiton përhapje më të madhe. Kurse kjo mendësi

është, për kohën tonë, rreziku më i madh, mangësia më e madhe, mungesa më e madhe. Anashkalimi i misionëve të profetëve në fushën metafizike, me fjalë të tjera, eliminimi i detyrës së tyre thelbësore, dhe, me kalimin e kohës, edhe vështirimi i fesë vetëm si rregull moral dhe si rregulla shoqërore të epokave të vjetra, është një përfundim dhe një tregues i shterpësisë ideore materialiste ku është zhytur dhe ka ngecur koha jonë."⁴³

Shumë kërkues dhe studiues besimtarë ose jo i kanë prekur cilësitë morale dhe gjenialitetin e Muhammedit. Vetëm se lidhja me revelacionin hyjnor dhe aspekti metafizik janë nënvleftësuar vazhdimisht. Mirëpo në burimet klasike islame, tregohet se "profetët zotërojnë një forcë mendore të lartë dhe kanë një moral të mrekullueshëm. Janë mbrojtur nga gabimet, aktet i kanë me burim revelacionin hyjnor."⁴⁴ Forca mendore e lartë, morali i bukur, drejtësia dhe ndershmëria si dhe personaliteti që zgjon ndër njerëzit siguri, janë cilësi të njohura të Profetit në Periudhën Paraislamike Pagane dhe Politeiste dhe të miratuara nga njerëzit.⁴⁵ Profetësia e tij është bërë e mundur, krahës veçorive të përmendura, me lidhjen e tij me botën e padukshme (okultiste). Profetësia e tij nuk plotësohet pa lidhjen me revelacionin hyjnor dhe pa pafajësinë (inoçencën). Për rrjedhojë, entiteti i tij i vërtetë është e pamundur të kuptohet duke i lënë mënjane cilësitë shpirtërore dhe të shenjta vetëm duke qëndruar mbi veçoritë temporale. Sepse, siç e ka thënë edhe Schuon-i, "Muhamedi është ngarkuar me detyrën profetike jo si rrjedhim i gjenialitetit njerëzor kurrësi të dyshimtë, por, në thelb, si rezultat i një zgjedhjeje hyjnore."⁴⁶ Edhe sistemimi i informacioneve të librave historike dhe bio-bibliografike në mënyrë të sinqertë dhe të paanshme, madje, është i pamjaftueshëm për ta kuptuar "personalitetin shpirtëror" dhe "entitetin e shenjtë" të të Dërguarit të Madh. Sepse në vepra të tilla është qëndruar vetëm mbi aspektin njerëzor të tij.⁴⁷ Është si pasojë e kësaj që myslimanët, për të shprehur dashurinë e tyre për Profetin, kanë kërkuar forma shprehjeje të tjera dhe më të lira. Në periudhat e para, studimet mbi argumentet profetike dhe veçoritë profetike, kasidet e shkruara për të treguar dashurinë e ndjerë përballë tij, janë produkte shkencore dhe letrare të shfaqura gjithë po prej kësaj nevojë. Fakti që himnet fetare që flasin për dashurinë e ndjerë përballë Profetit, kasidet dhe ceremonitë e mevludit, janë njëri nga motivet fetare më të rëndësishme që edhe në ditët tona i emocionojnë myslimanët, i bëjnë bashkë⁴⁸, pa asnjë dyshim e përshkruajnë Profetin (s.a.s.) me syrin e zemrës dhe ndjenjave.

43. Karakoç, s. 105, 106.

44. Fahrüddin er-Râzî, en-Nübüvvât ve mâ yete'alleku biha, Beyrut 1986, s. 8.

45. Ebu Hâtim er-Râzî, A'lâmü'n-nübüvve, nşr. Salah es-Savi, Gulam Rıza A'vani, Tahran 1977, s. 77 vd.

46. Schuon, Frithjof, a.g.e., s. 143.

47. Krş. Said Nursi, Mektubat, İstanbul 1990, s. 89.

48. Gibb, Hamiltorn A.R., İslam Medeniyeti Üzerine Araştırmalar, çev. Heyet, İstanbul 1991, s. 213.

37. Bk. Hodgson, a.g.e., I, 106-127.

38. Cahen, a.g.e., I, 21.

39. Muhammed Esed, Yolların Ayrılış Noktasında İslâm, çev. Hayreddin Karaman, İstanbul 1997, s. 95.

40. Seyyid Hüseyin Nasr, a.g.e., s. 76-79.

41. Karakoç, Sezai, Fizikötesi Açısından Ufuklar ve Daha Ötesi II, İstanbul 1995, s. 106.

42. Seyyid Hüseyin Nasr, a.g.e., s. 82, 83.



PUSHIMET *e myslimanit*



فَإِذَا فَرَغْتَ فَانصَبْ ٧
وَإِلَىٰ رَبِّكَ فَارْغَبْ ٨

“Prandaj, kur të çlirohesh (nga punët e ndryshme), përpiku fort (në adhurim) dhe vetëm ndaj Zotit tënd përkushtohu!” (Sherh, 94:7-8)

Pushimi dhe qetësimi i pjesshëm i shpirtit janë gjëra të dobishme dhe të rëndësishme. Njeriu i ditëve të sotme ka në përgjithësi një rutinë të imponuar nga mënyra e jetesës. Por qoftë edhe puna më fisnike dhe më e dobishme, nëse nuk alternohet, bëhet e vështirë që sadopak ta freskojë njeriun dhe kështu ne përballemi me monotoni, bezdi dhe mërzitje, që na lodhin dhe na demotivojnë.

Një situatë e tillë mund të ndodhë edhe gjatë adhurimit dhe përkushtimit fetar. Sepse kjo ka të bëjë me njeriun dhe ekuilibrat që Allahu ka vendosur në krijimin e tij. Në këtë rast, i Dërguari ynë (paqja qoftë mbi të) i ka penguar gjithmonë ata që, me dëshirën për të bërë sa më shumë adhurim, e rëndonin veten deri në atë pikë sa të shkaktonin lodhje dhe bezdi shpirtërore. Ka kërkuar prej tyre që të kenë një jetë cilësore dhe të ekuilibruar.

P.sh., nëna jonë e nderuar Zejneb bint Xhahsh (r.anha), bashkëshortja e Profetit Muhamed (s.a.s.), ndër të tjera, ishte e njohur për përkushtimin e saj në adhurim. Ajo e vëzhgonte me kujdes Profetin Muhamed (s.a.s.) dhe përpiquej ta ndiqte në çdo gjë që ai (s.a.s.) bënte. Kjo grua fisnike nga Kurejshët e konsideronte pak faljen e dyzet rekateve namaz në ditë, prandaj vazhdonte me namaze vullnetare. Ajo kishte fiksuar në mendje faktin se dynjaja është e përkohshme dhe se duhet shfrytëzuar sa më mirë për jetën e përjetshme. Për këtë arsye i kushtohej adhurimit me aq përkushtim, sa shpesh agjëronte dhe falej vazhdimisht. Madje, në disa raste lidhej me litar në shtyllat e xhamisë që as gjumi mos ta pengojë nga adhurimi.

Një ose dy herë, Profeti (s.a.s) e paralajmëroi për këtë. Në një rast tjetër Ai (a.s.) tha: “Zgjidheni atë litar; le të pushojë dhe të vazhdojë adhurimin, pasi të çlodhet.”

Po të vërejmë me kujdes, kuptojmë se arsyeja e ndalimit nga ana e Profetit (s.a.s.) ishte vetëm për të mirën e saj dhe të adhurimit që kryente. Sepse adhurimi i një trupi të lodhur dhe të rraskapitur, sa vetëdije, sa thellësi do të ketë? Nisur nga kjo dijetarët kanë thënë që nëse ke për të falur namaz por të ka pushtuar lodhja, atëherë lejohet ta shtysh atë për ta falur një moment të dytë, sigurisht brenda vaktit të vet.

Konceptin e çlodhjes dhe të pushimeve, mund ta mendojmë në logjikën e ajetit:

فَإِذَا فَرَغْتَ فَانصَبْ ٧ وَإِلَىٰ رَبِّكَ فَارْغَبْ ٨

Prandaj, kur të lirohesh (nga punët e ndryshme), përpiku fort (në adhurim) dhe vetëm ndaj Zotit tënd përkushtohu! (Sherh, 94:7-8)

Kështu që kemi dy parime:

1 - Myslimani kur përfundon një punë, angazhohet në diçka tjetër.

2 - Në çdo punë që bën, synon kënaqësinë e Allahut, që do të thotë se bën punë të dobishme me vështirimin gjithmonë kah jeta e përtejme. Sepse dynjaja është jeta e punës dhe veprimi, ndërkohë që pushimin myslimani do ta bëjë në ahiret.

Nisur nga këto dy parime, nëse po bën një punë që të lodh fizikisht, më pas ndryshon dhe bën dhikr, lexon Kuran, etj., pra bën diçka që kalit shpirtin. Kur nis të të lodhë kjo e dyta, atëherë kalon në diçka fizike dhe kështu me radhë.

Prandaj, myslimani në periudha të caktuara në ambientet të shtëpisë së tij, herë lexon Kuran, herë studion libra të ndryshëm. Kur del jashtë, herë përpiket të takohet me miqtë e tij, herë merr edhe familjen dhe shkon diku, bën kryesisht udhëtime që pasurojnë kulturën e vlerave si mysliman, si qytetar apo si atdhetar. Kështu hyn në një atmosferë tjetër, përjeton diçka të re dhe origjinale, ai rigjallërohet.

Në fund kthehet vendbanimin e tij dhe jeton për një kohë me kujtimet e udhëtimeve që bëri. Më pas thur ëndrra dhe bën planet për udhëtimin e radhës. Në këtë mënyrë ruan vazhdimisht një atmosferë të gjallë dhe freskuese. Atëherë myslimani, edhe pushimet përpiket që t'i kryejë duke u marrë me gjëra të dobishme. E shfrytëzon si një moment për t'u ripërtërirë, forcuar dhe gjallëruar. Dhe kjo është e nevojshme, sepse ata që bëjnë gjithmonë të njëjtat gjëra, kanë më shumë gjasa të mërziten.

Kurse pushime të pakujdesshme, që ushqejnë dëshira të ulëta apo shoqëria me njerëz të kësaj kategorie, ndoshta mund të shërbejnë për çlodhjen e trupit, por do të lodhin shpirtin. Dhe kjo nuk i vlen as vetë myslimanit dhe as familjes së tij.

Prandaj, vëllezër dhe motra, le t'i shfrytëzojmë pushimet dhe kohën e lirë si mundësi për t'u afruar më shumë me Allahun, për të forcuar lidhjet familjare, për tu përkushtuar më shumë ndaj fëmijëve të cilët i neglizhojmë nga ngarkesa e punës gjatë vitit, për të pasuruar dijen dhe për të rigjallëruar shpirtin tonë. Allahu na bëftë prej atyre që e përdorin kohën në mënyrën më të mirë dhe që e fitojnë kënaqësinë e Tij në çdo gjendje. Amin.

01 KRYETARI SPAHIU VIZITON AMBASADORIN E RI TË AMBASADËS SË ARABISË SAUDITE NË TIRANË



Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, vizitoi Ambasadorin e ri të Mbretërisë së Arabisë Saudite në Republikën e Shqipërisë, Shkëlqesinë e Tij, z. Turki bin Ibrahim Al-Madi.

Me këtë rast, Kryetari Spahiu i uroi ambasadorit mirëseardhjen në vendin tonë dhe suksese në përmbushjen e misionit të tij diplomatik, duke vlerësuar rolin e rëndësishëm që marrëdhëniet mes dy vendeve tona kanë luajtur në forcimin e bashkëpunimit në fusha të ndryshme.

Nga ana e tij, Ambasadori Al-Madi e falenderoi Kryetarin e KMSH-së për vizitën dhe vlerësoi bashkëpunimin e deritanishëm ndërmjet institucioneve tona, duke shprehur gatishmërinë për ta thelluar më tej atë në të ardhmen.

Gjatë bisedës, të dy krerët shkëmbyen mendime mbi çështje të ndryshme me interes të përbashkët, duke u ndalur veçanërisht në rëndësinë e promovimit të vlerave fetare, dialogut, bashkëpunimit institucional dhe forcimit të urave të komunikimit ndërmjet institucioneve përkatëse.

Në këtë takim, Kryetari Spahiu shoqërohej nga Nënkryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Lauren Luli, si dhe Këshilltari i Kryetarit për marrëdhëniet me vendet arabe, z. Jamal Al-Safarti.



02 INSTITUTI I STUDIMEVE ISLAME "HAFIZ SABRI KOÇI" DIPLOMOI 26 STUDENTË NË VITIN E TIJ TË PESTË



Në ambientet e Kolegjit Universitar "Bedër" u zhvillua ceremonia e diplomimit të brezit të pestë të studentëve të Institutit të Studimeve Islame "Hafiz Sabri Koçi", të cilët përfunduan me sukses programin njëvjeçar të formimit të përgjithshëm fetar.

Gjatë këtij viti, instituti diplomoi 26 studentë dhe studente, duke vijuar misionin e tij në përgatitjen e kadrove të rinj me njohuri bazë islame në shërbim të komunitetit.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast morën pjesë Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, Nënkrjetari, z. Taulant Bica, Drejtori i Drejtorisë së Kulturës në KMSH, z. Dorian Demetja, Administratori i Kolegjit Universitar "Bedër", z. Syrjan Shehu, këshilltari i kryetarit për Marrëdhëniet me Botën Arabe, Dr. Jamal Alsafarti, si dhe studentët e diplomuar.

Programi njëvjeçar i studimit ka për qëllim pajisjen e pjesëmarrësve me njohuri themelore në Kuran, Hadith, Tefsir, Fikh, Akaid, Histori Islame dhe fusha të tjera të rëndësishme të formimit fetar.

Në fjalën e tij, Kryetari i KMSH-së, z. Spahiu, uroi studentët për arritjen e tyre dhe vlerësoi kontributin që Instituti i Studimeve Islame "Hafiz Sabri Koçi" ka dhënë përgjatë pesë viteve të aktivitetit, duke theksuar rëndësinë e përgatitjes së brezave të rinj për nevojat në këtë aspekt. Përhëndetje mbajtën gjithashtu edhe Nënkrjetari Taulant Bica, z. Demetja, z. Shehu dhe Dr. Alsafarti, të cilët përgëzuan studentët për përkushtimin e treguar gjatë vitit akademik dhe i inkurajuan që dijet e fituara t'i shndërrojnë në kontribut të dobishëm për komunitetin.

Në përmbyllje të ceremonisë, studentët u pajisën me certifikatat e përfundimit të programit, të cilat iu dorëzuan nga Kryetari i KMSH-së.



03 KOLEGJI UNIVERSITAR "BEDËR" DIPLOMON BREZIN E TREMBËDHJETË TË STUDENTËVE



Në një atmosferë emocionuese dhe festive, Kolegji Universitar "Bedër" organizoi ceremoninë e diplomimit të brezit të 13-të të studentëve, të cilët përfunduan me sukses rrugëtimin e tyre akademik.

Ceremonia, e zhvilluar në prani të familjarëve, stafit akademik dhe përfaqësuesve të institucioneve partnere, kurorëzoi përpjekjet dhe arritjet e studentëve të programeve të ciklit të parë të studimeve (Bachelor dhe Profesional) dhe të ciklit të dytë (Master).

Në emër të institucionit, të diplomuarit i përshëndeti Rectori i Kolegjit Universitar "Bedër", Prof. Dr. Gjergj Sinani, i cili vlerësoi përkushtimin, punën e palodhur dhe angazhimin e studentëve gjatë viteve të studimit, duke i inkurajuar ata të vijnë rrugën e dijes dhe profesionalizmit.

Një përshëndetje për studentët dha edhe Nënkrjetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Z. Lauren Luli, i cili i përgëzoi për arritjen e këtij momenti të rëndësishëm në jetën e tyre dhe uroi që rrugëtimi i tyre i mëtejshëm të jetë i mbushur me suksese, përgjegjësi dhe kontribute pozitive në shoqëri.

Urime të përzemërta të gjithë të diplomuarve!





04 KRYESIA E KOMUNITETIT MYSLIMAN TË SHQIPËRISË ZHVILLOI TAKIMET VJETORE ME MYFTINITË



Kryesia e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë zhvilloi takimet vjetore me myftinitë e vendit në kuadër të planifikimit pesëvjeçar të punës, të hartuar në vitin 2024.

Gjatë këtyre takimeve, të zhvilluara përgjatë dy javëve të fundit, u diskutua mbi veprimtarinë e myftinive për periudhën korrik 2025 – qershor 2026, me fokus të veçantë performancën e përgjithshme në aspektin fetar dhe administrativ, zhvillimin e projekteve të reja, si dhe ecurinë krahasuese me vitet e mëparshme.

Myftinjtë, të ndarë në grupe, paraqitën raportet përkatëse të veprimtarisë së tyre përpara Kryesisë së institucionit dhe Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu. Raportimet përfshinë çështje të rëndësishme, si: zhvillimi i kurseve fetare për fëmijë; mirëmenaxhimi i vakëfeve të disponueshme; kontrolli i shpenzimeve dhe investimeve; kontrolli i arkave të xhamive; pagesa e kuotës statutore; organizimi i Umres nga KMSH-ja; procesi i anëtarësimeve; mbledhja e sadakasë dhe zekatit; abonimet në revistën “Drita Islame”; organizimi periodik i mbledhjeve me Këshillin e Myftinisë dhe stafin; si dhe projektet e reja në dobi të komunitetit.

Po ashtu, gjatë këtyre mbledhjeve, myftinjtë paraqitën një sërë sugjerimesh për aspekte të ndryshme të punës së përditshme, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të veprimtarisë institucionale dhe të shërbimit ndaj besimtarëve.

Përmes këtyre takimeve synohet rritja e efikasitetit, transparencës dhe përgjegjshmërisë në veprimtarinë fetare dhe administrative të çdo myftinie në vend.

Gjithashtu, këto takime të përbashkëta shërbyen edhe si një mundësi e vyer për shkëmbimin e eksperiencave ndërmjet myftinive, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit dhe forcimin e bashkëpunimit.



05 ZHVILLON PUNIMET FORUMI EVROPIAN "SHARED SACRED FLOURISHING"



Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, mori pjesë në punimet e Forumit Evropian "Shared Sacred Flourishing", i zhvilluar në Tiranë, ku u mbledhën përfaqësues të komuniteteve fetare, institucioneve ndërfetare dhe organizatave ndërkombëtare nga vende të ndryshme të Europës dhe më gjerë.

Forum i Evropian "Shared Sacred Flourishing" mbledhi në Tiranë drejtues fetarë, akademikë, përfaqësues të institucioneve publike dhe organizatave ndërkombëtare nga vende të ndryshme të Europës dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. I organizuar nga Religions for Peace International, European National Interreligious Bodies dhe Religions for Peace Europe, në bashkëpunim me Këshillin Ndërfetar të Shqipërisë dhe komunitetet fetare në vend, forumi synoi të nxistë dialogun ndërfetar dhe ndërkulturor, të forcojë bashkëpunimin mes aktorëve fetarë e shoqërorë, si dhe të promovojë kontributin e besimit në ndërtimin e paqes, kohezionit social, drejtësisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, theksoi në fjalën e tij përshëndetëse se zhvillimi i qëndrueshëm i shoqërisë ndërtohet mbi vlera të përhershme shpirtërore, si dinjiteti njerëzor, drejtësia, mëshira dhe përgjegjësia e përbashkët. Duke u ndalur te tema e forumit, "Shared Sacred Flourishing", ai nënvizoi se Islami e sheh mirëqenien e njeriut si një tërësi që përfshin si dimensionin material, ashtu edhe atë shpirtëror, ndërsa dinjiteti njerëzor është një vlerë universale që i përket çdo qenieje.



Dy pika dhe dy gjurmë më të dashura për Allahun



"Për Allahun nuk ka asgjë më të dashur se dy pika dhe dy gjurmë: pika e lotit që derdhet si shprehje e besimit dhe bindjes së thellë, nga frika dhe respekti ndaj Allahut dhe pika e gjakut që derdhet në rrugën e Allahut gjatë luftës. Ndërsa dy gjurmët, janë gjurma e plagës e marrë gjatë përbaljes në rrugën e Allahut dhe gjurma e adhurimit që mbetet nga përmbushja e njërit prej obligimeve hyjnore." (Tirmidhi, Fedailu'l-Xhihad, 26)

Në të vërtetë, sikur besimtari ta dinte se çfarë vlere dhe peshe kanë pranë Allahut dy pika lot dhe dy pika gjak të derdhura për Të, ai do të fluturonte nga gëzimi si pëllumbat, duke dëshiruar me zjarr ta arrinte atë gjendje dhe atë frymëzim. Mirëpo kjo gjendje lidhet ngushtë me një nivel të caktuar besimi dhe bindjeje të thellë shpirtërore.

Në lidhje me këtë çështje, i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: *"Në praninë e Allahut nuk ka asgjë më të dashur se dy pika: pika e lotit e derdhur si shprehje e besimit dhe bindjes ndaj Allahut dhe pika e gjakut e derdhur duke luftuar në rrugën e Allahut."*

Allahu i do jashtëzakonisht shumë këto dy pika. Për këtë arsye, njeriu që lidhet me ato gjëra që janë të dashura për Allahun dhe ia kushton veten atyre, nuk joshet kurrë nga kënaqësitë e rreme dhe të përkohshme të kësaj bote. Ai nuk përkulet para botës, por me gjithë vëmendjen dhe ndjeshmërinë e tij drejtohet kah bota tjetër. Megjithatë, e gjithë kjo është çështje e irfanit, e njohjes së thellë shpirtërore, dhe arritja e saj është ndër çështjet më të vështira, por jo e pa arritshme për njeriun.

Sipas botëkuptimit tonë, irfani është një dritë e fortë e besimit që digjet në zemrën e njeriut, e tillë që ai, nën ndriçimin e saj, e sheh botën ashtu siç e sheh

edhe botën e përtejme. Ashtu siç mediton dhe vëzhgon çështjet e kësaj bote, ai mediton dhe vëzhgon edhe çështjet e Ahiretit (botës tjetër). Atëherë, në zemrën e njeriut zgjohet një dëshirë e veçantë për botën tjetër dhe askush me mendje të shëndoshë nuk do ta parapëlqejë asgjë tjetër përballë përpjekjes në rrugën e Allahut dhe të rënit dëshmor (shihadetit) që fitohet në këtë rrugë. Fundja, si mundet që një njeri, i cili ka parë bukurinë e përjetshme dhe bukuritë e amshuara, të anojë drejt jetës së përkohshme të kësaj bote?

Shihadeti është garancia për arritjen e përjetësisë. Amr ibn Xhemuh (r.a) dhe Sa'd ibn Hajseme (r.a) janë ndër ata sahabe (shokë të Profetit a.s.) që e fituan këtë garanci. Të dy ishin mjaft të moshuar, nuk kishin fuqi as të ngriheshin nga shtrati, e as të ecnin pa shkop. Por sapo u përmend çështja e xhihadit (në këtë rast luftë fizike kundrejt armikut sulmues), ata u ngritën si luanë të plagosur dhe filluan të përgatiteshin për të marrë pjesë në të. Kur fëmijët dhe nipërit e tyre u përpoqën t'i ndalonin duke u thënë: "Babai ynë, ti je i sëmurë, mezi ecën edhe në rrugë. Kjo punë nuk është për ty. Ti rri në shtëpi, na lejo ne të dalim", ata u përgjigjën: "Sikur të ishte diçka tjetër, do t'ju kisha parapëlqyer juve ndaj vetes sime. Por kjo është çështje shihadeti (të rënit dëshmor); është çështje e takimit me Zotin dhe e fitimit të Xhenetit të përjetshëm. Në këtë çështje askush nuk mund të parapëlqejë askënd." Edhe pse ndodheshin në dy shtëpi të ndryshme dhe flisnin me njerëz të ndryshëm, debati ishte i njëjtë. Të dy grupet, pa e ditur për njëri-tjetrin, shkuan te i Dërguari i Allahut ﷺ për ta marrë atë si gjykatës, dhe të moshuarit u ankuan për të rinjtë: "O i Dërguari i Allahut ﷺ! Fëmijët dhe nipërit tanë nuk na lejojnë të shkojmë që të bëhemi dëshmorë dhe ta flijojmë shpirtin tonë me dëshirë për Ty." I Dërguari i

Allahut ﷻ u përpoq t'i qetësonte, por ishte e pamundur. Me sytë e ngulur drejt botës së Xheneteve dhe me një dëshirë të zjarrtë për t'u nisur sa më parë drejt saj, ata ngulnin këmbë aq shumë, saqë mësuesi i dy botëve ﷻ nuk gjeti rrugë tjetër veçse t'u thoshte të dyve: "Në rregull."

Si përfundim, të dy pleqtë morën pjesë në luftë. Pak më vonë, Profeti i nderuar ﷺ, me shikimin e drejtuar kah botët e larta, tha: "Po e shoh Amr ibn Xhemuhun, me këmbët e tij të të drejtuar, duke vrapuar drejt Xhenetit."

Kur u kërkuan dëshmorët, të dy pleqtë u gjetën të shtrirë në tokë, shpinë më shpinë. Si Sa'd ibn Hajseme (r.a), ashtu edhe Amr ibn Xhemuh (r.a) kishin rënë dëshmorë në rrugën e Allahut. Për këtë dëshmon Allahu, dëshmon i Dërguari i Tij dhe dëshmojnë edhe engjëjt. Këta dy dëshmorë kishin siguruar Xhenetin.

Njeriu mund ta jetojë edhe në këtë botë një jetë të mbushur me të njëjtin ideal dhe dëshirë. Vdekja dhe shehadeti bëhen për të qëllimet më të larta. Mirëpo kjo, siç u përmend më sipër, lidhet ngushtë me irfanin, me njohjen e thellë të së vërtetës. Sepse lotët e kësaj bote janë të qeshura gëzimi në botën tjetër; dhimbjet e kësaj bote janë kënaqësi atje; privimet dhe vështirësitë këtu janë lamtumira për çdo privim dhe vështirësi atje. Çdo njeri duhet t'ia përcjellë këto të vërteta ndërgjegjes së vet dhe t'ia përkujtojë vetes në këtë mënyrë. Për këtë arsye, analiza e së kaluarës sonë ka dobi të madhe për ne. Kjo vetëdije, ka vazhduar të jetë prezente që nga themeluesit e parë të këtij misioni të shenjtë Islam, e ka arritur deri tek ne pandërprerë. Për ata, përkushtimi dhe nëse është nevoja, flijimi i jetës për hir të fesë së Allahut ishte pothuajse një pasion dhe një dëshirë e zjarrtë. Megjithëse edhe ata e donin njeriun dhe jetën, duhej të ekzistonte një e vërtetë tjetër që i shtynte drejt kësaj rruge. Kjo e vërtetë mund të shpjegohet vetëm me faktin se ata kishin arritur në shkallën e irfanit (njohje e Allahut përmes zemrës dhe përjetimit shpirtëror). Kur'ani na e injekton këtë vetëdije. Ai shpall se ata që vdesin në shërbim të rrugës së Allahut nuk duhet të konsiderohen realisht të vdekur. Ata janë të gjallë pranë Allahut, me një jetë që ne nuk jemi në gjendje ta kuptojmë. Këtë jetë e kuptojnë vetëm ata që kanë arritur tek ajo dhe ata quhen shehidë.

Babai i Xhabirit, Abdullahu (r.a), kishte rënë dëshmor në Uhud. Xhabiri (r.a) shkoi te i Dërguari i Allahut ﷺ dhe i tha: "O i Dërguari i Allahut, babai im vdiq dhe la pas jetimë. Përkujdesja për ta ka mbetur mbi mua, ndërkohë që unë nuk kam as kushtet e nevojshme për t'i mbajtur." Më pas, i Dërguari i Allahut ﷺ shkoi në shtëpinë e tij për ta ngushëlluar. Në atë çast, vajza ose motra e Abdullahut (r.a) po qante me zë të lartë në dhomë, aq sa ta dëgjonte edhe Profeti. I Dërguari i Allahut ﷺ, me fjalë që ishin lajm i mirë jo vetëm për ta, por për të gjithë myslimanët, e ngushëlloi Xhabirin (r.) dhe familjen e tij duke thënë: "Deri më sot Allahu nuk

ka folur drejtpërdrejt me askënd. Vetëm Abdullahun e mori përballë dhe e pyeti për gjendjen e tij. Ai iu përgjigj Zotit: 'O Zoti im! Më kthe edhe një herë në botë, që të vdes sërish në rrugën Tënde dhe t'u tregoj njerëzve sa e këndshme është një vdekje e tillë.' Zoti i Madhërishëm i tha: 'Unë kam një premtim se të vdekurit nuk do të kthehen më në botë. Por dëshirën dhe mallin tënd do t'ua bëj të ditur atyre.' Më pas zbriti ajeti që shprehte se dëshmorët nuk konsiderohen të vdekur, dhe kështu u bë e qartë gjendja e Abdullahut (r.a) dhe e atyre si ai, se dëshmorët nuk kanë vdekur dhe kurrë nuk do të vdesin.

Lotët, për njerëzit e sinqertë dhe të pastër në besim, janë një lloj çlirimi shpirtëror. Për ata që digjen përbrenda, lotët janë shprehja e jashtme e ndjenjave të tyre. Sikur brenda gjoksit të tyre të digjeshin prushet e Xhehenemit, emocionet e tyre shndërrohen në lot. Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut ﷺ ka vendosur një ekuilibër midis Xhehenemit dhe lotëve. Kur shkëndijat e Xhehenemit ndjekin njerëzit në Ditën e Gjykimit, Xhibrili (a.s.) shfaqet me një gotë ujë në dorë. I Dërguari i Allahut ﷺ e pyet: "Çfarë ke në dorë?" dhe ai përgjigjet: "Lotët e besimtarëve, që ta shuajnë Xhehenemin." Me këto dhe hadithe të ngjashme, i Dërguari i Allahut ﷺ vlerëson njësoj veprën e atij që lufton kundër armikut të jashtëm dhe të atij që lufton kundër vetvetes, kundër egos së tij, dhe për këtë arsye derdh lot.

Kur'ani i Madhërishëm e paraqet gjendjen e atyre që qajnë si një mjet reflektimi dhe mësimi. Për më tepër, ka shumë ajete që urdhërojnë të qeshim pak dhe të qajmë shumë, si dhe të përkulemi nga pesha e mëkateve që kemi bërë. Çdo pikë loti, si dëshmi e hollësisë shpirtërore, është një drithërimë e ndjeshmërisë që ka vlerë sa burimet e Keutherit (lum në Xhenet, dy anë e të cilit janë prej ari dhe argjendi, shtrati prej xhevahireve dhe rubinëve ndërsa uji i tij është më i bardhë se qumështi dhe më i ëmbël se mjalti) në Xhenet. Tharja e lotëve është një gjendje e mjerueshme që meriton keqardhje. Ashtu siç i Dërguari i Allahut ﷺ i kërkonte strehë Allahut nga shejtani, po ashtu i kërkonte mbrojtje edhe nga syri i tharë që nuk loton. Sikur çdo besimtar ta kritikonte veten e tij me seriozitet dhe ta pranonte këtë të vërtetë të hidhur duke thënë: "Ah i mjeri unë që nuk kam dije, që nuk kam vepra të mira, që nuk kam më fuqi për mirësi dhe adhurim, që nuk kam lot në sy, as forcë në zemër e as vendosmëri në vullnet!.." Dhe sikur çdo besimtar ta bindte veten duke thënë: "Unë jam askushi. Nëse kam përfituar nga disa begati të Allahut, kjo nuk është për shkak të meritës sime, por për shkak të nevojës sime. Gjendja ime e mjerë e vë në lëvizje mëshirën e Allahut dhe të gjitha këto begati vijnë vetëm prej Tij!.."

Hapi i parë për t'u çliruar nga mangësitë është t'i njohësh ato si mangësi. Kjo njohje duhet të shoqërohet gjithmonë me një drithërimë të brendshme, në mënyrë që njeriu të arrijë të shpëtojë prej tyre.

KUR'ANI SI PASQYRË E VETES



"Kur'ani është pelhura me të cilën endet jeta e myslimanit; fjalitë e tij janë si fije nga të cilat thuret lënda e shpirtit të tij."
- Sejjid Husein Nasr

Jeta e gjithsecilit prej nesh kalon nëpër faza ku pyesim për veten tonë të vërtetë. Me kalimin e kohës mund të vëmë në pikëpyetje disa bindje që kemi mbajtur si pjesë e vetë identitetit tonë, një karakter për të cilin e kemi shquar veten dhe kemi thënë me bindje: ky jam unë. Njohja e vetes ka qenë dhe vazhdon të mbetet çështja më madhore që preokupon shpirtin e qenies njerëzore. Vlera e të gjithave traditave të mëdha fetare dhe filozofike është vlerësuar në aspektin se sa e kanë ndihmuar njeriun të gjejë veten e tij të vërtetë përballë ndryshimeve që ka përjetuar fati i tij.

Tradita Islame është një nga këto tradita të mëdha e cila ka ofruar një sërë veprash dhe idesh mbi natyrën e njeriut. Por pavarësisht korpusit të gjere që ofron kjo traditë ne ide dhe në metodë, loja e shpirtit njerëzor që bën me jetën, siç e thotë edhe Kur'ani, shkon duke rendur në përvoja të pafundme. Prandaj, edhe njerëzit me personalitet më të përshpirtshëm kanë pranuar se nuk është e lehtë të zaptohet shpirti njerëzor. Por në Islam, burimi i vetëm që mund ta pasqyrojë natyrën e vërtetë të shpirtit tonë dhe vetë natyrës së botës është Kur'ani. Intelktuali bashkëkohor Sejjid Husein Nasr në librin e tij Ideale dhe realitete të Islamit bën një krahasim që tregon sa e ngjashme është natyra dhe struktura e Kur'anit me natyrën e shpirtit tonë:

1. Sejjid Husein Nasr, Ideale dhe Realitete të Islamit, Tiranë: Zemra e Traditës, 2008, fq. 55.

"Duke qenë si bota, Kur'ani është gjithashtu shumësi në krerët, vargjet, fjalët dhe gërmat e tij. Ai përbëhet nga një botë idesh dhe formulash. Por ekziston një dallim i madh ndërmjet kësaj bote të Kur'anit dhe botës si e tillë. Dhe këtu shihet gjenialiteti i veçantë i Kur'anit. Ai përpiket ta zërë shpirtin në lojën e vet. Ai fillon duke luajtur lojën e shpirtit, lojën e paraqitjes së një fasade shumësie e larmie, me të cilën shpirti është i mësuar. Në takim të parë, shpirti zbulon të njëjtin diferencim e shumësi, me të cilin është mësuar përgjatë përvojës së tij me botën. Por brenda Kur'anit përmbahet paqe, harmoni e unitet që është pikërisht i kundërti i efektit të botës mbi shpirtin e njerëzve. Shumësia e jashtme e botës është e tillë që, në të, njeriu rend nga një gjë tek tjetra, pa gjetur kurrë paqe dhe kënaqje. Shpirti i tij vrapon nga një objekt dëshire në tjetrin, duke pandehur se do ta gjejë gëzimin pas qoshkut. Mirëpo, ai është një qoshk të cilin disi nuk e arrin kurrë.²"

Pra, duke qenë se shkrimet e shenjta pasqyrojnë më së miri natyrën e shpirtit njerëzor, atëherë njeriu më së miri mund të kuptojë vetën duke i lexuar ato. Në librin Kitab kunhu mā la budda li'l-Murid minhu të cilën Ibn 'Arabi u shkroi në formë këshillash për një nxënës, ai i tregon edhe mënyrën si të mund ta zbulojë dhe formojë karakter të qëndrueshëm përmes Kur'anit. Sipas Ibn 'Arabikut, Kur'ani nuk lexohet vetëm për t'u kuptuar, por për t'u përdorur si pasqyrë e vetes tonë (nefs). Prandaj ai i shkruan muridit të tij kështu:

"Kur të kalosh nëpër një sure apo ajet që kërkon lutje, lutu, kërko [gjithçka që Ai na ka premtuar, mëshirë, falje, mbrotje].

2. Po aty, fq. 66.



Kur të hasësh një ajet që fton në meditim dhe mësim (i' tibar), medito. Sillu me çdo ajet sipas asaj që i takon atij dhe sipas asaj që ai tregon prej cilësive (şifat). Shiko se cilat prej atyre cilësive gjenden tek ti dhe cilat të mungojnë. Për ato që i zotëron, falënderoje Atë. Për ato që të mungojnë, përpiku t'i fitosh. Dhe kur të lexosh përshkrimin e munafikëve (dyfytirëshve) dhe mohuesve (kuffar), shiko me sineritet në veten tënde: a gjendet tek ti ndonjë gjurmë e atyre cilësive apo jo?³

Sipas këshillës së Ibn 'Arabiut, njohja e vetes përmes Kur'anit nuk arrihet duke kërkuar vetëm kuptimin e ajeteve, por duke e kthyer çdo ajet në një pasqyrë të brendshme. Kur lexojmë për cilësitë e besimtarëve, duhet të pyesim veten se sa prej tyre jetojnë realisht në karakterin tonë; kur lexojmë për munafikët, zullumqarët, mendjemëdhenjtë apo mohuesit, duhet të kërkojmë me sineritet nëse ndonjë gjurmë e atyre prirjeve fshihet brenda nesh. Në këtë mënyrë, Kur'ani pushon së qeni vetëm një tekst që na flet për njerëzit e së kaluarës dhe bëhet një mjet i vazhdueshëm vetëzbulimi dhe pastrimi shpirtëror (tazkiye). Ose siç thotë Husein Nasr, se të gjithë aktorët e rrëfyer në Kur'an simbolizojnë forcat që ne kemi brenda nesh.⁴

Në Islam njeriu nuk interpretohet vetëm në koncepte filozofike, psikologjike apo vetëm të natyrës fizike. Por metoda e pasur intelektuale dhe praktike e Islamit i merr në konsideratë të gjitha këto aspekte duke synuar t'i integrojë

të gjitha në qendrën e saj, et-Tevhid. Duke synuar që përmes leximit të Kur'anit të hyjmë në një proces të transformimit tonë, dhe jo ta marrim vetëm si një ushtrim intelektual ose ritual, do na ndihmojë që të fitojmë një vetëdije më të thellë për virtytet, dobësitë, prirjet dhe potencialin e shpirtit tonë. Dhe ky proces leximi dhe transformimi nuk mbaron deri në frymën e fundit. Ashtu sikurse ekzistenca jashtë nesh ka shumë shtresa dhe nivele, po ashtu edhe natyra jonë lëviz nëpër përmasa të ndryshme të qenies tonë. Për këtë edhe Ibn 'Arabi vazhdon duke i shkruar nxënësit të tij:

"Ajo që është thelbësore për ty është të jetosh në gjendje vigjilence të pandërprerë, duke ruajtur vëmendjen ndaj gjithçkaje që ngrihet në mendjen dhe zemrën tënde. Vështroji mendimet dhe ndjenjat që shfaqen në horizontin e brendshëm të qenies sate; medito mbi to, shqyrtoji dhe dallo burimin e tyre. Përpiku t'i mbash nën drejtimin e vetëdijes shpirtërore."⁵

Sa më i vëmendshëm që bëhet shpirti ynë për natyrën e tij, aq më shumë fiton thellësi e njohuri rreth Kur'anit që e ndjek si një hartë për tek vetja. Sa më shumë i qëndrojmë besnik vetës tonë, aq më shumë merr kuptim bota përreth nesh. Atëherë fati ynë arrin në atë pikë integruese ku e gjithë hapësira tokësore dhe vetvetja bëhet dëshmi e të Vërtetit për ne.⁶ Dhe kjo dëshmi do vazhdojë për secilin prej nesh deri në momentin kur njeriu do të dëshmojë kundër vetvetes.⁷

3. Muhjidd-din Ebu Abdu-llah Muhammed bin 'Arabi el-Endelusi, Kitab kunhu mā la budda li'l-Murid minhu, pa vend dhe vit botimi, fq. 5.


4. Nasr, po aty, fq. 64.

5. Ibn 'Arebi, po aty, fq. 6.

6. Shih surja Fussilet 41:53.

7. Shih surja el-Kijameh 75:14.

A lejohet të lexoj fizikisht nga Kurani, **kur jam duke falur namaz?**



Leximi i Kuranit në namaz

Parimi i përgjithshëm në lidhje me këtë çështje është shprehur në Kuranin Famëlartë, ku thuhet:

فَأَقْرَءُوا مَا تَيَسَّرَ مِنَ الْقُرْآنِ

"Lexoni prej Kuranit, çfarë e keni më të lehtë për ta lexuar..." (Muzzemmil, 73:20)

Parimore është që personi të lexojë prej sureve dhe ajeteve që di më mirë përmendësh dhe të shmangë pasazhet që mund t'i ngatërrojë. Përndryshe kjo do ta shpërqendronte nga namazi dhe nga kryerja e një adhurimi, do të kthehej në një moment sforcimi.

Në anën tjetër, shprehet edhe fakti që leximi prej Kuranit dhe shikimi i tij janë adhurime më vete. Kështu që leximi nga Kurani në namaz, s'ka përse të pengojë adhurimin. Përkundrazi, i shton vlerë dhe sevape.

Shafitë, malikitë dhe hanbelitë janë të mendimit që edhe nëse lexon nga Kurani, namazi është i vlefshëm. Ky mendim bazohet kryesisht në një transmetim ku thuhet se Dhekuani (r.a.), që ishte shërbëtor i Aishes (r.anha), drejtonte namazin për teravi, duke lexuar nga Kurani (Shih: Shirbini, Mugni'l-muhtaxh, 1/353; Ibn Sahnun, el-Mudeuene, 1/224). Kjo është e vlefshme edhe për namazet farz, edhe për ato nafle. Imam Malik shton që në namazet farz kjo është një vepër e papëlqyeshme.

Kurse tek hanefitë, Imam Ebu Hanife është më strikti. Sipas tij ky veprim është problematik për dy shkaqe:

Pikë së pari, leximi nga Kurani, mbajtja e tij në dorë, hapja dhe mbyllja, vendosja diku dhe marrja përsëri në dorë, apo kthimi i faqeve dhe shikimi në të, konsiderohen veprime të shumta (amel kethir)[1] dhe kjo dëmton rregullsinë e brendshme të namazit (tadil el-erkan), respektimi i të cilës është vaxhib.

Një shkak i dytë i kundërshtisë ndaj veprës në fjalë, vjen edhe nga fakti se personi, duke lexuar nga Kurani, është duke mësuar diçka prej tij (telkin). Dhe procesi i të mësuarit gjatë namazit e prish faljen. Prandaj, sipas Ebu Hanifes, nëse lexon nga Kurani dhe nuk je hafiz, atëherë namazi prishet.

Nisur nga kjo analizë, disa juristë kanë arritur në konkluzionin që, nëse personi është hafiz dhe Kuranin e vendos në një mbajtëse në një vend të lartë nga ku mund ta lexojë pa e prekur, atëherë lejohet në namazet nafle (suplementare).

Imamejn (Ebu Jusufi dhe Muhamed esh-Shejbani), janë edhe më fleksibël kur bëhet fjalë për namazet nafle. Sipas tyre, tek naflet, edhe po mos të jetë hafiz, namazi quhet, por leximi nga Kurani është mekruh. Kjo

për faktin se kur nuk është hafiz, do të ketë vështirësi në lexim dhe do të shpërqendrohet nga namazi si rezultat i përpjekjes për të lexuar pa gabime (Shih: Ibn Nuxhejmi, el-Bahr, 2/11; Tahavi, Muhtasar Ihtilaf el-Ulema, 1/208).

Kur personi është imam, atëherë duhet pasur parasysh hadithi profetik (s.a.s.), ku thuhet:

يَوْمَ الْقَوْمِ أَقْرَأُوهُمْ لِكِتَابِ اللَّهِ، فَإِنْ كَانُوا فِي الْقِرَاءَةِ سَوَاءً، فَأَعْلَمَهُم بِالسُّنَّةِ

"Le t'u prijë njerëzve në namaz ai që e lexon më mirë Librin e Allahut. Nëse janë të barabartë në lexim, atëherë ai që e njeh më mirë Sunetin..." (Muslim, h.nr. 673)

Prandaj përparësi duhet t'i jepet kujt lexon më me lehtësi.

(Për më tepër informacion kliko: cilat-jane-kriteret-per-te-dale-imam-ne-namaz-dhe-si-eshte-radha)

Në rastin e jo arabëve, duke mos e pasur arabishten gjuhën mëmë, leximi duhet bërë nga pjesët e Kuranit që lexon më lehtë. Imami në fjalë duhet të shmangë pjesët e Kuranit që nuk i lexon dot rrjedhshëm. Sepse mund të bëjë gabime të rënda që ndikojnë kuptimin e ajeteve, gjithashtu shtohet vështirësia e zbatimit të rregullave të texhvidit. Pa e kuptuar mund të bëjë gabime që shkaktojnë prishjen e namazit.

Ndërsa leximi i sureve, ajeteve apo duave duke parë në një letër apo në shkrime në mur gjatë namazit e prish namazin. Prandaj një veprim i tillë duhet shmangur.

Konkluzion

Bazuar në këto sqarime, duke qenë se kjo çështje është objekt mospajtimi mes dijetarëve, shmangia e leximit prej Kuranit në namazet obligative, si namazet farz dhe vaxhib, është sjellja më e kujdesshme dhe më e sigurt për besimtarin. Ai duhet të ruajë një ekuilibër në disiplinën e namazit dhe përqendrimin (hushunë) gjatë tij. Ndërsa në namazet nafle ka më tepër liri veprimi, prandaj në raste të caktuara mund të themi lejohet falja e namazit duke lexuar nga Kurani.

Allahu di gjithçka më së miri. /insi.al/

[1] Amel kethir (veprime të shumta) janë quajtur veprime që bëjnë një shikues nga jashtë të mendojë se personi nuk është në namaz ose kryerja e disa lëvizjeve radhazi (si mbajtja e Mushafit, hapja, kthimi i faqeve) pa ndërprerje.

Edukimi fillon në familje



Nuk ka dhuratë më të bukur dhe më të çmuar për një prind sesa fëmija i tij. Që në momentin kur ai vjen në jetë, bashkë me gëzimin lind edhe një përgjegjësi e madhe, që të rritet dhe të edukohet sa më mirë.

Shpesh kur flasim për edukimin e fëmijëve, mendojmë për shkollimin, mësimet apo notat. Por në Islam, edukimi fillon shumë më herët dhe është shumë më i gjerë se kaq. Ai fillon në shtëpi, me fjalën e mirë, me shembullin e prindërve dhe me atmosferën që krijohet në familje.

Çfarë mbjellim tek ata në vitet e para të jetës, do të japë frytet e tyre më vonë. Nëse mbjellim dashuri, respekt, sinqeritet dhe

besim tek Allahu, me lejen e Tij do të korrim fëmijë me karakter të mirë, të fortë dhe zemër të pastër.

Shpesh prindërit shqetësohen për atë që u thonë fëmijëve, por harrojnë se fëmijët shohin më shumë sesa dëgjojnë. Ata na vëzhgojnë kur flasim me njëri-tjetrin, si sillemi me prindërit tanë, kur përballemi me vështirësitë apo kur falemi. Për këtë arsye, shembulli ynë është mësimi më i fortë që mund t'u japim.

Profeti Muhamed (a.s) na ka lënë modelin më të bukur në edukimin e fëmijëve. Ai ishte i dashur, i butë dhe plot mëshirë. I përqaftonte, luante me ta dhe u kushtonte vëmendje.



Kjo na tregon se zemra e fëmijës fitohet me dashuri, jo me ashpërsi.

Sot edukimi i fëmijëve është bërë më i vështirë se kurrë. Aparatet celulare, interneti dhe ndikimet e shumta nga jashtë kërkojnë më shumë kujdes nga prindërit. Fëmijët tanë kanë nevojë jo vetëm për ushqim dhe veshje, por edhe për kohën, për bisedat dhe praninë tonë.

Ndoshta nuk do t'i shohim menjëherë rezultatet e përpjekjeve që bëjmë. Do të ketë ditë të lodhshme, të vështira me gabime dhe sprova. Mirëpo çdo fjalë e mirë, çdo lutje e bërë për fëmijën dhe çdo përpjekje për ta udhëzuar

në rrugën e drejtë, ka vlerë tek Allahu.

Edukimi i fëmijëve nuk është vetëm kujdes për të tashmen e tyre, por edhe ndërtim i së ardhmes së tyre. Dhe çfarë mund të dojë më shumë një prind sesa të shohë fëmijën e tij të rritet me besim, moral dhe dashuri për Zotin e tij.

Le të mos harrojmë se fëmijët tanë nuk kanë nevojë për prindër të përsosur. Ata kanë nevojë për prindër që i duan, i dëgjojnë, luten për ta dhe përpiqen çdo ditë që t'i këshillojnë drejt së mirës. Kjo është një nga përgjegjësitë më të mëdha, por edhe një nga mirësitë më të bukura që Zoti i ka dhuruar njeriut...

Dinjiteti i individit në Islam **DHE BULLIZMI**



Dinjiteti i individit në Islam është i shenjtë dhe i garantuar nga ligjet dhe mekanizmat ligj-zbatuese të tij. Islami na mëson se askush nuk ka përparësi te Krijuesi Suprem me anë të cilësive apotributeve fizike, sociale apo pasurore. Është e vërtetë se njerëzit mburren midis njëri-tjetrit duke vënë në pah bukuritë fiziologjike, prejardhjen fisnore, forcën e pushtetit që posedojnë, resurset dhe rezervat e shumta ose me tepëri të pasurisë, sakaq krehohen dhe mburren për aftësitë intelektuale apo arritjet akademike. Kjo sjellje është një tregues i qartë i cektësisë dhe dobësisë së besimit që ai posedon. Kjo sjellje është kryekëput kompleksitet i njerëzve të ulët në karakter. Besimtari i mirë duhet të jetë vigjilent ndaj të folurës, sjelljeve dhe veprimeve të tij. Ka vetëm një mënyrë të lejuar me

të cilën ai ka të drejtë të garojë për epërsi, madje dhe kjo, jo për të poshtëruar të tjerët, por për t'u ngritur në grada të larta në konsideratën e Krijuesit. Ajo mënyrë është vetëm takvaja (devotshmëria). Allahu thotë në Kuranin Famëlartë rreth atyre që konsiderohen më fisnikët ndër njerëz, rreth atyre që kanë përparësi ndër njerëz te Ai :

”ان اكرمكم عند الله اتقاكم“

Pa dyshim se më fisnikët ndër jush te Allahu janë ata që posedojnë devotshmëri më shumë ndër jush”

[El huxhurat:13]

Pra, e vetmja peshore që bën diferencën për matjen e përparësisë është ajo e devocionit dhe vigjilencës. Nuk ka se si të ishte në linja të ndryshme praktika e Muhammed Mustafasë alejhiss salatu us selam kur i

këshillonte njerëzit se Allahu nuk merr në konsideratë për ta ngritur në grada të larta dikë ato kritere që njerëzit vlerësojnë në këtë dynja, por kriteret e zemrës dhe punës së mirë, pra përkushtimit dhe devotshmërisë. Ai sas tha :

“قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ: إِنَّ اللَّهَ لَا يَنْظُرُ إِلَى أَجْسَامِكُمْ، وَلَا إِلَى صُورِكُمْ، وَلَكِنْ يَنْظُرُ إِلَى قُلُوبِكُمْ وَأَعْمَالِكُمْ”
رواه مسلم.

“ Pa dyshim se Allahu nuk sheh trupat tuaj, as fizionomitë tuaja, por ai sheh ç'ka keni në zemër dhe atë çfarë ju punoni” [Transmeron Muslimi]

Në aktualitetin ku jetojmë dhe veprojmë vërejmë se fenomene të vjetra dhe primitive, e të rëndomta kanë marrë hov të tmerrshëm dhe përmasa të jashtëzakonshme. Fenomene të tilla si tallja, përbuzja apo bullizmi janë përhapur në masë të madhe te rinia por edhe më gjerë. Njerëzit tallin dhe vënë në lojë njëri tjetrin për shkak të ngjyrës së lëkurës, për shkak të fizionomisë apo krijimit me aftësi ndryshe, për shkak të prejardhjes fisnore apo edhe për shkak të varfërisë. Është evidente që ky fenomen ndodh rëndomtë edhe te besimtarët, edhe pse kjo dihet qartë që është e ndaluar rreptësisht në Islam. Allahu thotë në Kuranin Famëlartë :

“يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا يَسْخَرُ قَوْمٌ مِّن قَوْمٍ عَسَىٰ أَن يَكُونُوا خَيْرًا مِّنْهُمْ وَلَا نِسَاءٌ مِّن نِّسَاءٍ عَسَىٰ أَن يَكُنَّ خَيْرًا مِّنْهُنَّ وَلَا تَلْمِزُوا أَنفُسَكُمْ وَلَا تَنَابَزُوا بِالْأَلْقَابِ بِئْسَ الْأَسْمُ الْفُسُوقُ بَعْدَ الْإِيمَانِ وَمَن لَّمْ يَتُبْ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الظَّالِمُونَ

“ O ju që besuat, nuk bën të tallen një popull me një popull tjetër, meqë të përqeshurit mund të jenë më të mirë nga ata të cilët përqeshin dikë tjetër, e as gratë me gratë e tjera, sepse mund të ndodhë që gratë e tjera të jenë më të mira se ato që përqeshin (duke e nënçmuar njëri-tjetrin) dhe mos etiketoni njëri-tjetrin me pseudonime. Pas besimit është keq të përhapet pseudonimi i keq. E ata që nuk pendohen, janë mizorë” [El Huxhurat 11]

Ky përshkrim i këtij veprimi të ulët do ta bënte besimtarin të ndërgjegjësohet dhe të frenohet nga ky veprim i rebeluar ndaj urdhërësive të Zotit. Allahu gjithashtu thotë në Kuranin Famëlartë:

“وَيَلِّ لِكُلِّ هُمْزَةٍ لُّمْرَةً (1)“

“Mjerë për secilin që ofendon e përqesh ” [Humeze 1]

Ky është një kërcënim i qartë për ata që tallen dhe ofendojnë të tjerët. Përqeshja dhe tallja nënçmon dinjitetin dhe ul vetëbesimin te personi mbi të cilin kryhet veprimi. Ne jemi dëshmitarë që adoleshentë me natyrë të brishtë kanë shkuar deri në vetëvrasje për shkak të bullizimit. Por ky ves i shëmtuar nuk ndodh vetëm te adoleshentët. Ai ndodh te të gjithë grupmoshat. A e dini ju historinë e Ebu Dherr El Giffarit me Bilalin radia Allahu anhume?

Njëherë Ebu Dherri r.a e ofendoi Bilal Habeshiun r.a nga ngjyra e lëkurës duke iu shprehur “o i biri i zezakes”, dhe kjo i rëndoi muezinin të Profetit alejhi salam. Kur

e dëgjoi Profeti alejhi salam e qorti Ebu Dherrin r.a duke ia kujtuar atij “s’ka dyshim se te ti ka cilësi të injorancës”. E më pas Ebu Dherri r.a i kërkon falje Bilalit r.a me përlulësi shembullore duke i thënë se “ai nuk do të largohej derisa ai ta ketë falur dhe ndëshkuar veten duke vënë kokën e tij nën këmbët e Bilalit r.a”...

Por a e pranon Bilali r.a një poshtërim të tillë të një sahabi të Profetit alejhi salam?! Ai e fal dhe e ruan dinjitetin e vëllait të tij dhe përqafohen të pajtuar.

[Kjo ngjarje ka versione të ndryshme te Buhariu dhe Muslimi]

Citate profetike rreth kësaj teme janë të shumta. Për shembull Profeti alejhis salam thotë : “Mos e nënçmoni njëri-tjetrim. Do ti mjaftonte si mëkat dikujt nëse do të përçmojë vëllanë e tij musliman” [Buhariu]

Po, kjo është zgjidhja. Ne jemi qenie të gabueshme dhe mund ta humbim balancën e gjyqimit dhe veprimit në momente nervozizmi, e kështu mund të dëmtojmë dikë. Ajo që na duhet është të kthehemi të pikëlluar dhe të penduar te Allahu duke i shuar meritë dhe zemërimet midis atyre të cilët i kemi tallur apo përbuzur.



Etika e punës në Islam

وَلَقَدْ كَرَّمْنَا بَنِي آدَمَ

“Në i kemi nderuar bijtë e Ademit...”

أَعْطُوا الْاَجِيرَ اُجْرَهُ قَبْلَ اَنْ يَجِفَ عَرَقُهُ

Feja Islame përbën një sistem të integruar normash dhe parimesh me burim hyjnor, i cili synon rregullimin e gjithanshëm të jetës njerëzore, formimin e besimit, kultivimin e adhurimit dhe orientimin drejt njohjes së plotë të potencialit njerëzor. Nëpërmjet shpalljes së Kuranit Famëlartë, Allahu (xh.sh.) thekson se njeriu është nderuar dhe fisnikëruar për shkak të vetë qenies së tij njerëzore, duke kërkuar njëkohësisht që ky dinjitet të ruhet dhe të respektohet në mënyrë të ndërsjellë mes njerëzve. Duke qenë se feja i drejtohet drejtpërdrejt njeriut dhe është e pandashme nga dimensionin shoqëror i jetës, ajo vendos në qendër të vëmendjes marrëdhëniet sociale dhe ndër-njerëzore, si elemente thelbësore për funksionimin e shëndoshë të shoqërisë.

Thënë këtë, një nga parimet themelore të Islamit është vlerësimi i punës dhe përpjekjes së ndershme. Islami nuk e sheh punën thjesht si një nevojë ekonomike, por si një akt me vlerë shpirtërore dhe morale. Çdo përpjekje e sinqertë për të siguruar jetesën konsiderohet një formë adhurimi, nëse ajo bëhet me qëllim të pastër dhe në përputhje me normat e drejtësisë.

Në Kuran theksohet se njeriu do të marrë shpërblimin sipas asaj që ka punuar, duke çituar në ajetin 39 të sures Nexhm: *وَأَنْ لَّيْسَ لِلْإِنْسَانِ إِلَّا مَا سَعَى* “dhe se njeriu do të ketë vetëm atë për të cilën ka punuar;”³ Ky parim vendos një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet mundit dhe shpërblimit, duke e bërë drejtësinë një shtyllë të patjetërsueshme të jetës shoqërore. Puna e ndershme jo vetëm që siguron mirëqenie materiale, por gjithashtu ndërton karakterin, forcon përgjegjësinë dhe e afron njeriun me Krijuesin e tij. Në diskursin islam, puna dhe veprimi nënkupton, punën në rrugën e Zotit, në çështjet e besimit, por edhe puna që kryhet për të mbajtur

familjen, për të siguruar të ardhmen dhe për të kryer nevojat shoqërore.

Gjithashtu, Islami i kushton rëndësi të veçantë marrëdhënies ndërmjet punëtorit dhe punëdhënësit. Kjo marrëdhënie nuk është vetëm një marrëveshje ekonomike, por një përgjegjësi morale e ndërsjellë. Ajo duhet të ndërtohet mbi parime të qarta: drejtësi, ndershmëri, dinjitet, transparencë dhe respekt reciprok. Punëdhënësi është i obliguar që të trajtojë punëtorin me dinjitet dhe të mos e shfrytëzojë atë. Ai duhet të sigurojë kushte të drejta pune dhe të japë shpërblimin e merituar pa vonesë dhe të mos i bëjë padrejtësi atij. I Dërguari i Allahut, Profeti Muhamed (a.s), ka thënë: *أَعْطُوا الْاَجِيرَ اُجْرَهُ قَبْلَ اَنْ يَجِفَ عَرَقُهُ* “Jepjani punëtorit hakun para se t’i thahet djersa.” Ky udhëzim i fuqishëm përmbledh thelbin e drejtësisë ekonomike, respektimin e të drejtave dhe obligimeve ndaj punëtorit në islam.

Nga ana tjetër, punëtori gjithashtu mban përgjegjësi të rëndësishme. Ai duhet të kryejë detyrat e tij me përkushtim, korrektësi dhe ndershmëri. Ai nuk duhet të mashtrojë, të neglizhojë apo të abuzojë me kohën dhe besimin që i është dhënë. Puna e bërë me sinqeritet është një dëshmi e besimit dhe një rrugë drejt begatisë së jetës. Në këtë aspekt, një element thelbësor në marrëdhëniet e punës është qartësia e marrëveshjes. Islami kërkon që çdo marrëdhënie pune të bazohet në kushte të qarta dhe të përcaktuara mirë: paga, detyrat dhe kohëzgjatja duhet të jenë të njohura për të dyja palët që në fillim. Kjo shmang konfliktet dhe garanton drejtësi. Nëse kushtet janë të paqarta, hapet rruga për padrejtësi, shfrytëzim dhe keqkuptime. Prandaj, Islami nxit transparencën dhe besueshmërinë si elemente kyçe për një shoqëri të drejtë dhe të qëndrueshme.

Një aspekt tejet i rëndësishëm të cilin përciptazi e cekëm edhe më herët është dinjiteti i punëtorit. Islami e konsideron çdo njeri të nderuar dhe të respektuar, pavarësisht llojit të punës që kryen, për sa kohë ajo qëndron brenda kuadrit të të lejuarës sipas parimeve Islame. Nuk ka punë të “ulët”, për sa kohë ajo është e ndershme. Çdo profesion i lejuar është një kontribut në

1. Kuran, surja Isra, ajeti 70

2. Mishkat al-Masabih, 2987

3. Kuran, surja Nexhm, ajeti 39



ndërtimin e shoqërisë dhe duhet të vlerësohet si i tillë.

Paga që merr punëtori duhet të jetë në përputhshmëri me kushtet e kohës që jeton dhe e mjaftueshme për të siguruar një jetë të denjë. Ajo duhet të mbulojë nevojat bazë të jetesës dhe të mundësojë stabilitet për familjen. Një shoqëri që nuk garanton këtë drejtësi rrezikon të përballet me padrejtësi, varfëri dhe pabarazi. Këtu një përgjegjësi e madhe bie edhe mbi bizneset, pronarët e të cilëve janë besimtarë. Ata duhet të veprojnë si rregullatorë të një ekonomie konkurruese dhe të drejtë, duke e bazuar punën e tyre mbi parimet e qarta fetare, që na transmetohen qoftë nga Kurani apo nga Suneti profetik.

Nuk duhet harruar fakti që kjo fe është ndërtuar mbi parimin e drejtësisë dhe si i tillë, Islami e dënon ashpër shfrytëzimin dhe padrejtësinë ndaj njerëzve. Çdo formë e abuzimit me të drejtat e punëtorit është e papranueshme dhe bie ndesh me parimet themelore të fesë dhe kushtetutës. Drejtësia nuk është vetëm një vlerë morale, por një detyrim që duhet zbatuar në praktikë. Ndër të tjera në një hadith që na transmetohet nga Ebu Hurajra, profeti Muhamed (paqja e Zotit qoftë mbi Të) thotë:

عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: “ثَلَاثَةٌ أَنَا خَصْمُهُمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ وَمَنْ كُنْتُ خَصْمَهُ خَصِمْتَهُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ رَجُلٌ أَعْطَى بِي ثُمَّ غَدَرَ وَرَجُلٌ بَاعَ حُرًّا فَأَكَلَ ثَمَنَهُ وَرَجُلٌ اسْتَأْجَرَ أَجِيرًا فَاسْتَوْفَى مِنْهُ وَلَمْ يُوْفِهِ أَجْرَهُ.”⁴

4. Suneni i Ibn Maxhe, 2442

“Allahu xh.xh thotë: Unë jam armik i tre personave në Ditën e Gjykimit, ... (ndër ta) ai që punëson dikë dhe nuk i jep hakun e tij.”

Në një shoqëri ku respektohen këto parime, krijohet një ekuilibër i qëndrueshëm. Punëdhënësi dhe punëtori nuk janë në konflikt, por në bashkëpunim për të arritur të mirën e përbashkët. Drejtësia sjell besim, dhe besimi sjell stabilitet dhe zhvillim. Në të kundërtën, kur këto parime shkelen, lind padrejtësia, pakënaqësia dhe përçarja. Prandaj, secili prej nesh duhet të reflektojë mbi rolin e tij. Nëse jemi punëdhënës, duhet të jemi të drejtë dhe të mëshirshëm. Nëse jemi punëtorë, duhet të jemi të ndershëm dhe të përkushtuar. Vetëm në këtë mënyrë mund të ndërtojmë një shoqëri të drejtë dhe të begatë.

Le të jetojmë më vetëdijën e lhsanit dhe të kujtojmë se çdo veprim i yni është nën mbikëqyrjen e Allahut. Çdo padrejtësi, sado e vogël, ka pasoja, dhe çdo e drejtë, sado e vogël, ka shpërblim. Le të jemi prej atyre që zgjedhin drejtësinë, edhe kur është e vështirë.

Lusim Allahun e Madhëruar që të na udhëzojë në rrugën e drejtë, të na bëjë prej atyre që respektojnë të drejtat e të tjerëve dhe që punojnë me ndershmëri. Lusim që Ai të na furnizojë me rizik të pastër dhe të begatë, dhe të na japë sukses në këtë botë dhe në tjetrën.

Mbi alegorinë e njeriut dhe përgjegjësinë e tij

Pozita e njeriut në këtë botë është shprehur kështu në formë alegorike nga Hz.Ali:

Njerëzit janë udhëtarë: kjo botë është një vend për të kaluar përkohësisht dhe jo për tu vendosur në të. Një jetë që fillon në mitrën e nënës dhe ka si mbërritje jetën e përtejme. Jetëgjatësia është distanca që ai do përshkojë. Vitet janë stacione, muajt parasagnat¹ e tij, ditët kilometra dhe frymëmarrja hapat e tij. Udhëtimi i njeriut në këtë botë i ngjan anijes që udhëton drejt destinacionit të saj përfundimtar.

Dikush tjetër do të thoshte:

Pashë një njeri të dhënë pas kësaj bote. Ai dukej i kënaqur dhe pakujdesshëm, por ai në fakt ishte një udhëtar, i detyruar të udhëtonte gjatë natës, ndonëse ai nuk e dinte këtë.

Njeriu është thirrur për në Mbretërinë e Paqes. Allahu thotë: Ata e kanë vendin e shpëtimit (Xhenetin) te Zoti i tyre.² Dhe Allahu thërret për në Xhenet.³ Në këtë rrugë njeriu është drejtuar tek lulet më të zgjedhura dhe frutat më të shijshme: në Xhenete në të cilët burojnë lumenj;⁴ për në një Xhenet, gjerësia e të cilit është si gjerësia e qiejve dhe e tokës, i përgatitur për të devotshmit.⁵ Meqenëse shtegu drejt Mbretërisë së Paqes është i terrët, i rrethuar me forcat djallëzore dhe errësira, Allahu na ka dhuruar intelektin dhe zbritur Librin e Tij si një dritë udhëzuese dhe na ka urdhëruar ta adhurojmë atë si një fortesë mbrojtjeje për ne. Ai e përshkruan kështu dritën e tij:

All-llahu është dritë i qiejve e i tokës. Shembulli i dritës së Tij i ngjason kandilit të vendosur në një zgavër të errët. Kandili gjendet brenda një qelqi si të ishte yll flakëruar e që ndizet prej (vajit të) një druri të bekuar, prej ullirit që nuk mund të quhet as i lindjes e as i perëndimit, e vaji i tij ndriçon pothuajse edhe pa e prekur zjarri. Dritë mbi dritë. All-llahu udhëzon kah drita e Vet atë që do Ai. All-llahu sjell shembuj për njerëzit. All-llahu çdo gjë di shumë mirë.⁶

Ai e përdor kandilin për të përshkruar intelektin, zgavrën për të përshkruar perceptimin e besimtarit, qelqin për të përshkruar zemrën dhe pemën e bekuar që është ulliri simbolizon fenë. Pema e bekuar nuk është as prej lindjes dhe as prej perëndimit për të treguar se është e mbrojtur prej mangësisë dhe teprisë. Allahu na siguron duke thënë: Me të vërtetë që Ky Kuran udhëzon drejt asaj që është më e drejtë.⁷

Vaji simbolizon Kuranin. Allahu na shpjegon se Kurani mbështet intelektin ashtu sikurse vaji mbështet llambën, dhe se Kurani është i vetëmjaftueshëm në qartësinë e Tij edhe pa ndihmën e intelektit. Dritë mbi dritë i referohet dritës së Kuranit dhe dritës së intelektit. Favori i Allahut është për këdo qoftë që kërkon dritën e Kuranit dhe të intelektit. Ai ka siguruar mbrojtjen absolute për robërit e Tij. Ai i drejtohet shejtanit duke thënë: Me të vërtetë ti nuk do të kesh kurrfarë pushteti mbi robërit e mi.⁸ Këta shërbëtorë janë ata të cilët janë të mbrojtur nga devocioni për Zotin. Por ata të cilët tregohen mospërfillës për dritën e tij, për mbrojtjen e Tij, janë të mbështjellë në errësirë dhe të mashtruar nga armiqtë. Allahu na paralajmëron duke thënë: Kush mbyll sytë para përmendjes së Gjithëmëshirshmit, atij ia shoqërojmë një djall që nuk i ndahet kurrë. E ata (djajtë) do t'i shmangin nga rruga e drejtë, kurse (jobesimtarët) mendojnë se janë duke i udhëzuar.⁹

Kjo është ajo që ndodh me njeriun i cili nuk grumbullon nga kjo botë duke iu bindur urdhrit të Zotit, kështu: përgatituni me furnizim (për rrugë), e furnizimi më i mirë është devotshmëria.¹⁰ Njeriu i cili nuk përgatitet për Ahiretin në një moment do të dorëzojë çfarë ka marrë hua përfshirë trupin dhe pasurinë e tij. Ai do të vajtojë por nuk do të ketë më dobi. Ai do të thotë: Ah! Sikur të ktheheshim pas, mos t'i përgënjeshtrojmë shenjat e Zotit tonë dhe të bëheshim prej besimtarëve.¹¹

Ata do të thonë: A ka ndonjë ndërmjetësues që

1. Njësi matëse në kulturën perse, midis 5-5.5 km.

2. Surja El-Enam, 6:127

3. Surja Junus 10:25

4. Surja El-Enam 3:195

5. Surja El-Enam 3:133

6. Surja Nur, 24:35.

7. Surja Isra 17:9

8. Surja Hixhr 15:42

9. Surja Zuhuruf 43:36,37

10. Surja Bekare, 2:197

11. Surja Enam, 6:27

angazhohet për ne, ose të kthehemi (në këtë jetë), që të punojmë ndryshe seç kemi punuar.¹² Por në atë stacion të ekzistencës pendesa nuk do të bëjë dobi për ata që nuk kanë besuar në jetën e kësaj bote.¹³

Nga një tjetër perspektivë, njeriu është porsifermeri në këtë botë. Puna e tij është kultivimi, jeta në këtë botë është toka; koha e vdekjes korra dhe jeta tjetër vendi i grumbullimit. Ai do të korrë atë çka do të mbjellë. Në Fjalën e Tij Zoti thotë: Kush është që dëshiron fitimin e botës tjetër (ahiretin), Ne do t'ia shtojmë fitimin e tij, e kush e dëshiron vetëm fitimin e kësaj bote, Ne ia japim, po në botën tjetër ai nuk do të ketë shpërblim.¹⁴

Bota tjetër është një magazinë ku gjenden mjete matëse, njerëz të besuar, mbrojtës, vëzhgues dhe shkruer. Allahu i Lartësuar premton: Ne në ditën e gjykimit do të vendosim peshore të drejtë dhe askujt nuk do t'i bëhet padrejtësi; nëse diçka peshon vetëm sa grimca, Ne atë do ta shpërblejmë, dhe mjafton që ta llogarisim vetëm Ne.¹⁵ Ai na kujton se: Dhe mbi ju, me siguri, vigjilojnë. Shkruer fisnikë. Të cilët dinë se çka punoni;¹⁶ dhe na tregojnë se Edhe Toka do të shkëlqejë me dritën e Zotit të vet, do të vihet Libri, do të sillen profetët dhe dëshmitarët dhe të tërë do të gjykohen me drejtësi, atyre nuk u bëhet padrejtësi.¹⁷ Në të njëjtën mënyrë sikurse drithi dhe kashta shoshoiten në dysheme, edhe veprat e mira dhe të këqija do të shoshiten në jetën e pëtejme. Ashtu sikurse Ai thotë se për t'i dalluar All-llahu të mirët nga të pamirët dhe që t'i radhisë të pamirët njërin afër tjetrit e pastaj t'i mbledh të gjithë së bashku dhe t'i hedhë në Xhehenem. Ata me të vërtetë janë të humbur.¹⁸

Allahu i përshkruan veprat e jobesimtarëve kështu: E, veprat e atyre që nuk besojnë, janë si mjegullirë në rrafshirë, të cilën, i etshmi e konsideron ujë, por kur të arrijë tek ai vend, nuk gjen asgjë, - e do të hasë në dënimin e Zotit dhe Ai ia paguan llogarinë e tij, se Allahu është llogaritës i shpejtë.¹⁹ Allahu i Lartësuar thotë gjithashtu: Vepra e atyre që nuk besojnë Zotin e tyre, i shëmbëllen hirit, që në ditën e stuhishme bartet nga era. Nuk do të kenë asnjë dobi nga veprat që kanë punuar. Kjo është humbje e madhe;²⁰ Dhe, Ne - do t'i qasemi veprës që kanë punuar ata dhe do ta shndërrojmë atë në

pluhur të shpërndarë.²¹ Kushdo që punon për jetën e pëtejme do ta gjejë shpërblimin sipas punëve të tij: E, kush dëshiron botën tjetër dhe përpigjet për të, e është besimtar, përpjekja e tyre është e falënderuar.²² Dhe kushdo që lufton për këtë botë do të dështojë dhe paralajmërohet solemnisht se përpjekjet e tij nuk do të kenë dobi: Ata që e duan vetëm jetën e kësaj bote dhe bukuritë e saj, Ne do t'ua plotësojmë krejtësisht punët e tyre, dhe atyre në të nuk do t'u mungohet asgjë. Këta janë ata, që në botën tjetër nuk do të kenë kurrigjë, përveç zjarrit. Do t'u shembet çdo gjë që kanë punuar në të këtë botë dhe do t'u humbet ajo që kanë punuar.²³

Njeriu në këtë jetë është porsipema e kalafit²⁴, ose si oleandra dhe kolonkita²⁵. Në pranverë dikush mund ti shikojë gjethet e tyre të harlisura deri në kohën frutave. Por ato nuk rriten të gjata dhe kur vjen e koha e prodhimit frutat e tyre janë të padobishme. Në të kundërt veprat e botës tjetër janë porsihardhia e rrushit dhe palma e hurmës: të pahijshme duken në dimër, por në kohën e vjeljes lulëzon prodhimi i cili mund të ruhet edhe për përdorim të mëvonshëm. Kështu Allahu thotë:

A nuk e sheh se Allahu sjell shembull fjalën e mirë sikur pemën e mirë, rrënja e së cilës është e ngulitur fort, kurse degët i ka kah qielli. Me leje të Zotit të vet i jep frytet e veta në çdo kohë, dhe Allahu u sjell shembuj njerëzve, ndoshta do të mendojnë. Kurse shembulli i fjalës së keqe është si pema e keqe që është e nxjerrë nga sipërfaqja e tokës dhe nuk ekziston më.²⁶

Kur lulet e kësaj bote janë së jashtmi të pastërta dhe të shëmtuara së brendshmi, Allahu na paralajmëron për të mos u mashtruar nga bukuria e jashtme e tyre: Dhe kurrësi mos të ikë syri në ato bukuri të kësaj bote me të cilat ne i kënaqim grupe të ndryshme prej tyre, për t'i vënë në sprovë me të, sepse shpërblimi i Zotit tënd është më i mirë dhe i pafund.²⁷

Allahu e ndihmon këdo qoftë që dëshiron përmes virtuteve të Tij, dhe ai është Krijuesi.

Përktheu: Abdullah Bulku

12. Surja Araf 7:53

13. Surja Enam 6:158

14. Surja Shuura 42:20

15. Surja Enbija, 21:47

16. Surja Infitar 82, 10:12

17. Surja Zumer 39:69

18. Surja Enfal 8:37

19. Surja Nur 24:39

20. Surja Ibrahim 14:18

21. Surja Furkan 25:23

22. Surja Isra 17:19

23. Hud 11:15,16

24. Khallāf është një pemë e njohur që gjendet me bollëk në vendet arabe, por rrallë gjendet në shkretëtirë. Ajo është një lloj i pemës safsaf. Quhet gjithashtu sawxhar. Ka shumë lloje të saj, të gjitha të buta dhe të dobëta. Sot njihet si Salix aegyptia of Linnaeus (lloj shëlgju).

25. Citrullus colocyntu është një lloj bostani shumë i hidhur që përdorej kundër helmimit nga gjarpërinjtë dhe akrepat.

26. Ibrahim 14:24-26

27. Taha 20:131

NDERIM BOTËS ME MË TË LAVDËRUARIN E GJITHËSISË

(Lindja e Muhamed Mustafasë)

"O Pejgamber, me të vërtetë që Ne të dërguam ty dëshmuës, përgëzues dhe këshillues, dhe me urdhrin e Allahut, thirrës për në rrugën e Tij dhe pishtar ndriçues". (Kuran: El-Ahzab, 45, 46)

"Vërtetë Allahu derdhi mbi besimtarët mirësi të madhe kur Ai dërgoi ndërmjet tyre një të dërguar (Muhamedin) nga mesi i tyre, i cili do t'iu lexojë atyre argumentet e Tij, t'i pastrojë ata nga mëkatet dhe do t'ua mësojë atyre Librin (Kuranin) dhe Urtësinë (Sunetin), ndonëse para kësaj ata kanë qenë krejtësisht të humbur". (Kuran: Ali Imran, 164)

Ibrahimi a.s. deri sa i ngrinte muret e Qabesë së bashku me të birin Ismailin, në një moment iu drejtua Zotit duke e lutur: **"Zoti ynë, dërgo ndër ta, një të dërguar nga gjiri i tyre, që t'ua lexojë atyre argumentet Tua, t'ua mësojë atyre Librin dhe Urtësinë, e ti pastrojë ata (prej ndyrësisë së idhujtarisë). S'ka dyshim se Ti je Madhështori, i Gjithëdijshmi (i Urti)."**

U desh të kalojë një kohë e konsideruar, u desh që Dielli të lindë e të perëndojë shumë herë, u desh që Hëna të rihet e të plotësohet shumë herë, u desh që shumë erëra të fryjnë e të përshkojnë shkretëtirën, madje kaluan edhe shekuj, derisa Allahu i Gjithëmëshirshëm ia pranoi lutjen Ibrahimit dhe e dërgoi atë që shndriti gjithësinë, Tokën dhe qiejt, të gjitha krijesat. E dërgoi më të zgjedhurin e Tij - Muhamedin (a.s.).


Në prag të shekullit VI bota ishte në një gjendje skajshmërisht të vështirë e në veçanti ajo e Siujdhesës së Arabisë. Dominonin veset negative dhe të dëmshme për shoqërinë, kurse morali kishte rënë në një nivel tepër të ulët. Ishin kohë të vështira atëbotë, të vështira aq shumë sa që njerëzit më me ëndje e dëshironin vdekjen se sa jetën. Pak ose aspak fusha të jetës kishin ngelur pa u prekur nga imoraliteti e degjenerimi njerëzor.

Dhe pikërisht në ato momente dramatike, mëshira e Allahut shndriti gjithësinë, shndriti njerëzimin.

Ishte ditë e hënë, 12 Rebiu-l-evvel ose 20 prill 571, kur lindi më i zgjedhuri i Allahut, Muhamedi.

Gëzimi s'kishte kufi. Gjyshi i tij Abdyl-Muttalibi, sapo e mori lajmin për lindjen e nipit, vajti ke dhoma e resë së tij Emines, e përgëzoi për këtë lindje dhe e mori nipin dhe me të vajti te Qabeja, me ç'rast edhe i vuri emrin Muhamed, një emër jo edhe i panjohur, por rrallëherë i dëgjuar. Në pyetjen se pse e emëroi pikërisht kështu, gjyshi Abdy-l-Muttalibi do të përgjigjej: "Dëshiroja që ai të bëhet i falënderuar nga të gjithë".

Fëmijërinë e hershme e kaloi në fshat, tek fisi benu Sa'd, pranë gjirit të Halimes, në ajër të pastër e larg zhurmës urbane. Babai Abdullahu i kishte vdekur akoma pa lindur Muhamedi e edhe e ëma do ta linte jetim që nga mosha gjashtëvjeçare. Ndryshe edhe nuk mund të ndodhte, sepse, duke qenë se atë e përgatiste Allahu për mision universal, atë edhe do ta përgatiste vetë Ai - Allahu (xh.sh.), sepse Ai më së miri e di se si duhet edukuar, rritur dhe përgatitur për një mision të tillë universal.



Gjatë kohës sa ishte i ri, ai do të merrej me ruajtjen e bagëtisë së xhaxhait të tij Ebu Talibit e gjithashtu edhe me pak tregti, ku edhe tregohet mjaft besnik, i drejtë dhe i sinqertë, e në moshën 25-vjeçare do të martohet me zonjën mekase, Hadixhenë, tek e cila do të gjente prehjen e ngrohtë familjare.

Si i ri që ishte, ai paraqiste modelin e njeriut me moral të përkryer, shpirti i tij, edhe para se t'i zbriste shpallja, ishte i shkëlqyer nga besnikëria, sinqeriteti, urtësia. Ndër moshatarët e tij dallohej shumë pikërisht për shkak të nivelit të lartë njerëzor, shpirtit të madh e human dhe modestisë së madhe që kishte. Ai bëri një jetë të thjeshtë dhe modeste, dukshëm i tërhequr nga të tjerët, ndoshta edhe për faktin se ishte i bindur se ajo që ata bënin ishte në kundërshtim me normat njerëzore dhe ajo që ata besonin ishte, po ashtu, në kundërshtim me mendjen e shëndoshë. Pikërisht, në këtë kohë, kur ai i kishte mbushur të dyzetat, derisa ai i vetmuar në periferi të qytetit, te shpella Hira meditonte për një rrugëzgjdhje nga kjo idhujtari, do të fillojë t'i zbrisë shpallja. Më 17 janar 611 Besniku-Xhibrili (a.s.) do t'ia përcjellë besnikut – Muhamedit fjalët e para të Allahut, për të vazhduar ky mision për 23 vjet me radhë.

Në të vërtetë, deri në ardhjen e Muhamedit (a.s.), u pa se njerëzia nuk është në gjendje që në bazë të logjikës së shëndoshë ta gjente të vërtetën, rrugën e Allahut të Lartëmadhëruar dhe shpëtimin në këtë botë e në botën tjetër. Kështu, Allahu i Gjithëmëshirshëm zgjodhi në personalitetin e Muhamedit (a.s.) bartësin e misionit të shenjtë, të cilit ia dërgoi imperativin e parë për të lexuar, studiuar, e hulumtuar në emër të Allahut. Në fillim, për shkak të gjendjes shoqërore ekzistuese nga njëra anë dhe për shkak të rëndësisë së misionit nga ana tjetër, shpallja do t'iu kumtohet njerëzve fshehtas, e me kalimin e kohës Pejgamberit do t'i urdhërohet **"Dhe tërhiqja vërejtjen fafesisit tënd më të afërm"**, për të vazhduar më vonë për 23 vjet në vazhdimësi dhe kontinuitet të shpërndajë dritë e lumturi. Këtu dhe do të fillojë ndryshimi i tërësishëm i historisë, do të fillojë të shkëlqejë rilindja njerëzore. Tashmë do të fillojë që bota të fitojë një ndriçim të ri, i cili do të angazhohet në zhdukjen e fanatizmit, injorancës dhe errësirës shekullore. Tashmë do të ndryshojë rrënjësisht filozofia e jetës, njeriu do ta adhurojë Krijuesin e vërtetë, do t'i respektojë vlerat njerëzore dhe do të mbjellë farën e dashurisë mbarë njerëzore. Muhamedi (a.s.), me një rast, do të deklarojë:

"O njerëz, ta dini se unë jam i dërguari i Allahut për të gjithë ju për t'ju treguar fenë e vërtetë të Zotit, fe të cilën e kanë pasur të gjithë pejgamberët e Zotit, por që me kalimin e kohës njerëzit e

ndryshuan dhe futën shumë gënjeshtër dhe shumë risi të shpikura, ndaj, unë me urdhrin e Zotit po e dëllir dhe po e pastroj dhe kështu po ia kthej origjinalitetin e saj."

Pra, islami është fe e natyrshme e çdo njeriu, me të lindë dhe konceptet e tij janë të gjera sa edhe vetë njerëzimi. Fundja, a nuk ishte islami feja e Ademit, Nuhut, Ibrahimit, Musait, Isait dhe e të gjithë vëllezërve të tyre pejgamberë?!

Nga të gjitha virtytet dhe cilësitë e larta me të cilat ishte i pajisur më i dashuri i Allahut, Allahu në Kuran e potencon moralin e tij të lartë kur thotë... **"Ti vërtet je në pedestalin më të lartë të moralit"**. Kurse zonja Aishe tregon se Pejgamberi) a.s.(moralin e morri nga Kurani: "Moralin e tij ishte Kurani".

Në të vërtetë, vetë jeta e Pejgamberit)a.s.(ishte shembull për brezin që jetoi në kohën e tij- ashabet, e po ashtu edhe për brezat që do të pasojnë gjer në përfundim të kësaj bote. Me një rast, Pejgamberi do të shprehë: *"Jam dërguar (nga Allahu) për ta plotësuar moralin e bukur"*.

Ai këshillonte për përkorësi dhe modesti në këtë botë, sepse kështu do të meritosh që Allahu të të dojë ty. Me një rast, Pejgamberi porositi: "Kur të falësh namazin, fale atë sikur të ishte namazi yt i fundit! Mos e thuaj fjalën për të cilën nesër ke për t'u penduar! Mos dëshiro atë që dëshirojnë njerëzit pa ditur gjë!"

E dikush, sot me të drejtë mund të pyesë: Vallë ku ka ngelur sot morali i myslimanit? Sa po e ndjekim sot shembëlltërinë e më të dashurit tonë? Sa po i pasojmë këshillat kuranore dhe porositë pejgamberiane?!

Pejgamberi sillte me shumë dhembshuri ndaj të varfërve, shpesh kishte qejf që nivelin e ulët të mirëqenies së tyre materiale t'ua zëvendësonte duke iu ndihmuar me çka kishte mundësi, ose së paku me një buzëqeshje apo fjalë të ngrohtë. Abdullah bin Amri tregon: "Një ditë, Pejgamberi a.s. hyri në xhami. Të varfrit qenë ulur në një skaj. Për t'i respektuar dhe për t'ua përfutur zemrën ai u ul pranë tyre, nisi të bisedonte me ta dhe tha:

"Përgëzime muhaxhirëve të varfër. Ata do të hyjnë në kopshtet xhenetit dyzet vjet para të pasurve. Meqë nuk kanë pasur pasuri, llogaridhënia e tyre do të mbarojë shpejt". E, me një rast, bashkëshortesë së tij i pati thënë: "O Aishe, kurrë mos e kthe prapë nevojtarin që të vjen në derë! Mbroje veten nga zjarri i xhehenemit qoftë edhe me një gjysmë hurme!"

Gjatë misionit të tij profetik, Muhamedi (a.s.) u ballafaqua me sfida të ndryshme, me tortura rrëqethëse, por, asnjëherë dhe për asnjë moment nuk u hamend për amanetin që kishte mbi supet

e tij. Madje, për dallim nga pejgamberët e tjerë, sa herë që armiqtë e sulmonin, e torturonin dhe i bënin keq, ai e luste Zotin: *"O Zot, udhëzoi në rrugë të drejtë dhe fali se ata nuk janë duke e ditur."*

Me një rast, zonja Aishe e paskësh pyetur Pejgamberin (a.s.) nëse ka përjetuar ditë më të vështirë se në Uhud? Ai ishte përgjigjur: "Po, kur jam kthyer nga Taifi, nga familja e Beni Abdi-Kilabit, më injoruan, madje më gjuajtën edhe me gurë e më përgjakën, e unë u dëshpërova jashtë mase. Në atë moment më ka ardhur melekui e më ka thënë: "Sikur të urdhëronte zotëria juaj, me emër të Allahut, këto dy kodrina do t'i rrafshoja e ata që të dëbuan do të mbuloheshin nën dhe e gërmadha."

- *"Ja, sepse shpresoj se edhe nga ata do të lindë ndonjë fëmijë i cili do t'i besojë Allahut"* - i ishte përgjigjur Pejgamberi melaqes. Përafërsisht kështu i kishte thënë edhe melaqja e erës (ciklonit), pastaj melaqja e shiut...dhe kishin marrë të njëjtën përgjigje.

Prandaj, për Muhamedin (a.s.) nuk mund të thuhet ndryshe përveçse ai ishte si dielli, rrezet dhe ngrohtësia e të cilit nuk janë pronë e askujt dhe as që i takojnë një lloji të caktuar, një gjinie të caktuar, një klani të caktuar, një mjedisi të caktuar, por prej dritës dhe rrezeve të tij ka dobi e tërë jeta, pra nga virtytet e larta të Muhamedit (a.s.) nga fisnikëria e jetës së tij, nga synimet dhe përpjekjet e tij, me udhëzime për të drejtuar njerëzit në këtë jetë dhe për të siguruar shpëtimin në botën tjetër, ka dobi dhe do të fitojë secili që i pranon dhe i zbaton udhëzimet e tij.

Dhe sot, tek sa bota islame feston ditëlindjen e më të Dërguarit të Allahut - Muhamedit (a.s.) të themi se për të kanë folur e kanë shkruar njerëz të ndryshëm, mendimtarë e eruditë të famshëm. Për të kanë shkruar edhe ata që e kanë besuar Allahun (xh.sh.), por edhe ata që nuk e kanë besuar. Sa për përkujtim do t'i sjellim, me këtë rast, disa vargje të Sherif Putrës dhe Ibn Haxhr El-Hajtemiut, gjithnjë duke mos pretenduar se ia kanë dhënë hakun:

I nderuari Sherif Putra ka shkruar: "Muhamedi a.s. ishte i pajisur me cilësi të bukura e tërheqëse, ai kishte një zgjuarsiri të hollë e të mprehtë, një kujtesë të fuqishme, mendje të gatshme, kuptim të shpejtë, parafytyrim të gjallë, kishte veti tepër të mira dhe të lakmueshme, një shpirt atdhedashurie shëmbullore dhe durim të pakufishëm, ishte një gjeni që komandonte dhe konsultoej me shokët dhe të tjerët. Ai kishte një kurajë plot guxim, serioz me karakter të qëndrueshëm, në takimin e parë të bënte për

vete, kishte delikatesë dhe ndjenja të pjekura. Ai ishte i thjeshtë, i dhimbshëm dhe i gjerë me jetën familjare, tërheqës në mënyrën e veprimit, solidar i atyre që u ndodhte ndonjë fatkeqësi, i dashur e përfillës kundrejt shokëve e familjes, baba i dhembshur dhe burrë bujar e zemërgjerë. Ai ishte njeri me gjykime të shkëlqyera, i ëmbël dhe kënaqës në bisedime, moscenues në sjelljet e të tjerëve dhe popullor i madh me inferiorët. Ai ishte shumë i sjellshëm në të pritur, në të përcjellur e në të bërët vizita, ishte një dashurues i flaktë për fëmijë, ai i ndalonte në rrugë ata, i përkëdhelte, i lëmonte e u fliste fjalë të ëmbla. Ai nuk e donte atë njeri që nuk e donte fëmijën e vet, ai e urrente deri në palcë rrenën. Ai ishte, me të vërtetë, njeri i patranditur, i pamërzitur, i besueshëm, vëllazëror, i dashur, shpirtmadh, këmbëngulës në të kryerit e detyrave fetare, trim e i zellshëm në punën që do të bënte dhe i paqortueshëm për sjelljet personale dhe familjare..."

Ndërkaq, Ibn Haxhen Hajtemi ka deklaruar: "Në këtë natë (fjala është për natën e mevludit) të gjitha krijesat, melekët, xhindet e kafshët si dhe metalet e pashpirt u japin myzhde njëritjetrit duke u gëzuar se ndriçoi botën nderi i gjithësisë".

Pejgamberi (a.s.) nuk la trashëgim tjetër, përveç Kuranit dhe Synnetit, pra Islamit dhe disa qindra mija myslimanë, për të arritur kjo shifër sot afër dy miliardë. Sot nuk ka vend ose mjedis në tërë rruzullin tokësor e të mos ketë besimtarë islamë, ithtarë të Muhamedit (a.s.). Krahas faktit se ai përmendet dhe mbi të bien salavat miliarda myslimanë, mbi të gjitha emrin e tij Allahu e krahasoi me emrin e vet:

لا إله إلا الله محمد رسول الله La ilahe il-lallah Muhamedun Resulull-llah. Vallë, a ka nder më të madh se ky?!!

Sa do që të shkruhet për Muhamedin (a.s.) në ditëlindjen e tij, gjuha jonë është tepër e varfër. E varfër sidomos karshi asaj që Allahu për të në Kuran ka thënë: **"Lart ta kemi ngritur emrin tënd"**.

Lumturia e vërtetë në të dyja jetët do të arrihet nëse zbatohen parimet e mësimave të Pejgamberit (a.s.) në jetën tonë dhe nëse për shëmbëlltyrë e kemi më të dashurin e Allahut, atë që me ardhjen e tij ndriçoi gjithësinë atë që nderoi njerëzinë.

Allahu i Madhërishëm na tregon në Kuran: "...**Pra, ata të cilët e besojnë atë, e nderojnë dhe e ndihmojnë, veprojnë në dritën e asaj që i zbriti, të tillët janë të shpëtuarit**". (Araf: 157).



Me shokët e Profetit ﷺ



"O i Dërguar i Allahut. - iu drejtua Ukbe bin Amir - Më trego për një sjellje dhe vepër të tillë që, pasi ta përvetësoj dhe ta kryej atë, nga njëra anë ta fitoj kënaqësinë e Allahut xh.sh., kurse nga ana tjetër të jem shembull me ndikim për shoqërinë në të cilën jetoj." I Dërguari i Allahut e porositi: "Shko te personi që nuk të vjen. Jepi personit që nuk të jep. Fale personin që të bën padrejtësi. Ja një vepër që të bën ta fitosh pëlqimin e Krijuesit tënd dhe një sjellje që do të ndjellë dashuri ndaj Islamit." Sa bukur! Ky është zberthimi më i drejtpërdrejtë dhe më i thjeshtë në vepra konkrete i mësimit kuranor, që i drejtohet myslimanit nëpërmjet ajeteve: "Të keqen ktheje me më të mirën..." (Kur'an, 23/96) "Nuk është e barabartë e mira dhe e keqja. Andaj, (të keqen) ktheje në mënyrën më të mirë, se atëherë ai, me të cilin kishit njëfarë armiqësie, do të bëhet mik i afërt. Mirëpo, këtë nuk mund ta arrijë kush, përveç atyre që janë të durueshëm dhe, nuk mund ta arrijë kush, përveç atyre që kanë virtut të lartë." (Kur'an, 41/34-35)

Mos luani me zjarrin

Në jetëshkrimin e Profetit Muhamed a.s. hasim edhe historinë e Alkames. Ai ishte një nga shokët e Profetit a.s. Kur i erdhi vdekja nuk e shqiptonte dot shehadetin. Shqiptonte çdo fjalë tjetër përveç shehadetit. Të pranishmit nxituan për te Profeti a.s. dhe i treguan gjendjen e tij. Profeti a.s. i pyeti: "A e ka nënën gjallë?"

"Po." - i thanë.

Profeti a.s. shkoi te nëna e tij dhe e pyeti: "A ka ndodhur ndonjë gjë jo e mirë mes teje dhe djalit tënd?"

"Po, o i dërguar i Allahut. Fëmijëve dhe gruas së tij u jep fruta të mira, kurse mua më jep çfarë tepron. Ndërkohë që unë jam e ëma", - u përgjigj nëna.

Me qëllim që ta zbuste zemrën e nënës, Profeti a.s. u tha shokëve: "Ndizni një zjarr dhe hidheni Alkamen të digjet brenda."

Kur nëna dëgjoji këtë, thirri: "Mos e bëj, o i dërguar i Zotit, se e kam falur Alkamen."

Në ato çaste, Alkameja e shqiptoi shehadetin dhe ndërroi jetë.

Për këtë, Profeti a.s. sa herë që lutej, thoshte: "O Zot, të lutem që mbyllja e jetës së kësaj bote të jetë sa më e mirë. O Zot, më ndihmo që jetën e kësaj bote ta mbyll me veprat më të mira."

Imami dhe zonja e moshuar

Ajo ishte një zonjë dhe e kishte bërë zakon të lypë para derës së xhamisë. Një ditë, imami i xhamisë u ndal dhe e pyeti: "Zonjë e nderuar, si është e mundur që del e lyp, ndërkohë që ke një djalë në emigracion?!"

Zonja iu përgjigj: "Hoxhë efendi, siç e dini dhe ju, im shoq ka ndërruar jetë, kurse im bir ka vajtur në emigracion këtu e tetë muaj më parë. Ai më la ca para mënjane për të përballuar shpenzimet, por ato m'u mbaruan dhe, duke mos pasur ndonjë mundësi tjetër, dola të lyp."

Imami e pyeti: "Mirë, po a nuk të ndihmon fare djali? Nuk të dërgon fare para?"

Ajo u përgjigj: "Në fakt, çdo muaj më dërgon fotografi me ngjyra, të cilat unë i ngul me gozhdë në murin e dhomës."

Imami vendosi t'i shkojë për vizitë në shtëpi.

Pasi hyri brenda, ai mbeti i shokuar nga ajo që i panë sytë. Muri i dhomës ku jetonte zonja ishte i mbushur me dollarë të ngulur me gozhdë. I biri, i dërgonte çdo muaj një mijë dollarë. Ajo kishte tetë mijë dollarë, e megjithatë vazhdonte të lypte para portës së xhamisë."

Ai i tregoi se ato që i dërgonte i biri nuk ishin fotografi me ngjyra, por para dhe se jo që nuk kishte nevojë për të lypur, por me to mund të bënte një jetesë shumë të mirë.

Ky tregim ka një ngjashmëri të madhe me jetën e secilit prej nesh, por në një dimension tjetër. Shumë prej nesh e lypim paqen e brendshme, gëzimin, lumturinë dhe të bukurën tek të tjerët, kushdo qofshin ata, nga njerëz shumë të afërt te njerëz të largët. Kjo, edhe pse këto vlera i kemi brenda vetes sonë, të gozhduara diku në një qoshe të shpirtit, të harruara dhe të injoruara.

I moshuari dhe vlera e shikimit

Një të moshuari iu veshën sytë dhe për disa ditë e humbi shikimin. Pasi u vizitua te doktori ai i propozoi një operacion të lehtë dhe ashtu ndodhi. Pas operacionit sigurisht i erdhi shikimi dhe doktori i dorëzoi faturën e shpenzimeve. Pasi i hodhi një sy, të moshuarit i rrodhën lot. Doktori i prekur nga kjo i tha: "Nëse të duken shumë do mundohem të bëjmë një zbritje."

Por i moshuari ia ktheu: "Jo, nuk e kam hallin te shuma. Ajo që më bëri të qaj është fakti se Zoti m'i ka dhuruar këto sy me të cilët kam parë për 70 vite dhe asnjëherë nuk më dërgoi faturë."

Faleminderit Zot.



POEZI KUSHTUAR **Profetit Muhamed a.s.**

Ti moj erë e jugut që vjen nga Meqeja,
Nga vend i bukur ku ndodhet Qabeja.
Vallë ç'na ke sjellë ti nga Medineja?
Atje është Resuli edhe Sahabeja.
Ai është diell shokët yje janë,
Çdo dritëz që japin prej Atij e kanë.
Ai është burimi këta rryma janë,
Ujët si argjendi prej Atij e kanë.
Na i dhe evliat nahen si bilbili
I ka dehur era e këtij trëndafili.
Sillem përreth tij, digjem porsi flutur
Digjem për Nebiun, për nurin e bukur.
Vejsel Karaniu gufoi porsi valë
Për Resulin shkuli çdo dhëmb e dhëmballë.
Ibrahim Et'hemi flaku mbretërinë
U degdis në pyje për Ahmet Nebij.
Ligjëron romuza fyelli Mevlana,
Këndon bukurinë Ahmet Mustafa.
Shahu Nakshibendi kur e vështroi nur
Bota, tha, për mua s'vlen një kokërr grurë.
Mujdin Arabiu pse tha "enel flak"
Për ty ja Resul seç u mbyt në gjak.
Imami Azami nuk lëshon fetva
Vdiq syrgjyn i mjeri për Ty Mustafa.
Mesurin Hallaçin vetëm për një fjalë
Për ty ja Resul e rropën të gjallë.
Çohu ja Resul kush të ka ardh' mbi varr
Ahmet Rufajja të është ndezur zjarr.
Fahrudin Raziu dritë po kërkon
Se pa dritën tënde pena s'i punon.
Dridhet Idaiu! Mend e mia vanë
Si gjemi e mbytyr në det të paanë.
Vanë filozofët dhe s'u mbeti bojë
Ç'është ky mbret nga doli, që mbylli çdo gojë
Ky në shkollë s'ka qenë, dituri ku mori
Profesor s'pati, profesor nxorri.
Baltë i jemi Hajdarit Qerarit
Fatimes, së bijës Ahmedul Muftarit.
Baltë i jemi bërë ne imam Hysenit
Sadikut, Farukut, Osman Dhinëjnit.
Det'i shpirtit tim tani po merr valë
Lemë të shoh Resul, o Zot të qofsha falë.



HAP DYERT
XHAMIA E RE E TOPHANËS
NË QYTETIN E SHKODRËS

